

Mustafa Tukaj

Të ftuarit

(Dramë - komedi në tre akte)

Veprimi i parë

Pragmbrëmje.Nga larg,të turbullta, duken dritëhijet e ndërtesave të një qyteti.Pamja e një salloni të madh,të një apartamenti. Është kati i njëmbëdhjetë i një qiellgërvishtësi.Në ballë është një dritare e madhe.Herë pas here dallohen vetëtima të largëta,që shoqërohen nga gjëmime të shurdhëta. Kolltukë e orendi të ndryshme.Një tavolinë mesi, një minibar, portmanto.Në të majtë është një korridor që vjen nga ashensori. Salloni të shpie në tre dyer të ndryshme,njëra ballore,dy të tjerat anash. Kolltukët janë të shpërndarë në të gjithë sallonin. Diku, në një vend te dukshëm, ora e madhe e murit shënon gjashtë pa tre. Një djalosh i ri, i bëshëm e shpatullan si bodyguard, me shpinë nga salla vështron në dritare.Një mesogrua del nga njëra prej dyerve.

Zonja - Bëhu gati!

Djaloshi - Po afrohet një natë e ligë...

Zonja - Ti mendon, se nuk do të vinë?

Djaloshi - Dyshoj...Për pak mund të shpërthejë fortuna...Retë janë ulur aq poshtë,sa, po të hap dritaren, i kap me dorë...

Zonja – (vë buzën në gaz)Dritarja duhet bllokuar mirë...

Djaloshi – Oj, të bllokuar!...Mos e vrit mendjen!! kam marrë masat për çdo gjë...Po ti largoje atë drej shqetësimi nga fytyra,se të lexohet dukshëm...

Zonja – Vërtetë?!Ja,ja..po përpiqem!...Është emotive, e kupton...

Në korridorin që vjen nga ashensori duket një burrë rreth të pesëdhjetave me një borsalinë në kokë.I afrohet portes dhe shikon orën e dorës.Ora në mur tingëllon fort gjashtë herë.Menjëherë pas kësaj bie zilja e derës.Ata të dy shohin njeri tjetrin në sy. Zonja hyn në njërën nga dhomat,kurse djaloshi shkon të hap portën.

Burri me borsalinë – Mirëmbërëma!

Djaloshi – Mirëmbërëma!

Burri me borsalinë –Më falni, pallati 211,hyrja 4,apartamenti 33?

Djaloshi – Jeni i saktë...

Burri me borsalinë – Po,si të them,ju duhet të jeni në dijeni...unë, ja ku është, kam një ftesë për sonte në orën gjashtë...(*ia tregon*)

Djaloshi – Urdhëroni brenda,zotëri dhe zini vend!

Burri me borsalinë – (*hyn duke vështruar përreth dhe ulet në njërin nga kolltukët*)Të them të drejtën,mu duk një ftesë disi e çuditëshme.. Enigmë...As nga kush dërgohet,as qëllimi...asgjë.Vetëm një sigël në fund,edhe ajo e pakuptueshme...SHPDE.. Ç'është gjithë ky konspiracion,djalosh,a mund të më sqaroni diçka?

Djaloshi – Gjithëçka,do të sqarohet,zotëri,të jeni i bindur...Rehatohuni dhe ndërkohë pini diçka...Konjak?Skoç?Apo diçka joalkolike?

Burri me borsalinë – Ju faleminderit!Një limonsoda..(*i shërben dhe shkon te dera*)

Djaloshi – (*Është një burrë me mjekërr të dendur, mosha e të cilit është e vështirë të përcaktohet.Ai i zgjat ftesën.*)Urdhëroni, zotëri,zini vend!

Burri me mjekërr – (*hyn duke përpirë me sy gjithçka.Përshëndet burrin me borsalinë.*) Mirëmbërëma!

Burri me borsalinë - Mirëmbërëma!

Burri me mjekërr - Edhe ju,me ftesë?

Burri me borsalinë - Edhe unë me ftesë...

Burri me mjekërr - Di ndonjë gjë përse?

Burri me borsalinë - Jo,nuk di...

Burri me mjekërr - Ç'natë e keqe po afron...

Burri me borsalinë – Shumë e keqe...

Burri me mjekërr - Ne nuk e dimë, as sa do të qëndrojmë këtu... (*merr shishën e uiskit dhe hedh ca*)Gjithësesi,kur të mbarojmë punë,a mund të më merrni në makinën tuaj? Fortunën e kemi mbas dere...Gabova që erdha me linjë...Dhe hoqa të zitë e ullirit,sa gjeta pallatin...Nuk e kisha ditur, që paska gjithë këto blloqe pallatesh të larta këtu...Kur i kanë bërë xhanëm?Të fortë,janë për besë!.. Gjithë ato para! Ah!...Po,ju,ku e keni lënë makinën, në parkingun poshtë?

Burri me borsalinë - Nuk kam ardhur me makinë...Mora një taksi...

(*Në një interval të shkurtër kohor nga ashensori dalin dhe ndalen para portës së apartamentit një burrë që i ka kaluar të pesëdhjetat,me kostum luksoz dhe një grua rreth të dyzetave,por që jep për më tepër.Shikojnë njëri tjetrin,disi të habitur meqë njëkohësisht i drejtohen së njëjtës derë.Gruaja e përshëndet me kokë.*)

Gruaja - Edhe ju me ftesë?(*Burri me kostum luksoz,disi indiferent, pohon me kokë dhe i bie ziles*)

(*Djaloshi e hap derën,kontrollon ftesat dhe i fton brënda.Ata përshëndeten dhe zënë vend. Gruaja ruan ende nje bukuri femrore,nën atë fytyrë të lodhur,nga një jetë aspak e qetë.*)

(*një pauzë e mërzitëshme*)

Burri me mjekërr – (*ngrihet dhe i afrohet dritares*)Filluan piklat e para..Kushedi ç'fortunë do të jetë!...

Gruaja – Do zoti e çahen qiejt fare!..Një sahat e më parë ardhhtë kataklizmoja!...

Burri me mjekërr- (*i drejtohet burrit me kostum*)Me makinë tuaj keni ardhur?

Burri me kostum - A ka shumë rëndësi kjo për ju?

Burri me mjekërr – Sigurisht..Pasi të marrim vesh, se kush dhe përse na ka mbledhur, do të njihemi më mirë me njeri tjetrin, me një fjalë do të bëhemi miq dhe miqtë nuk e lejnë njëri tjetrin të qullet nën një rrebesh të tillë...Unë, për vete erdha me linjën urbane...(hedh pak uiski ne gotën e vet)Të të hedh ca?

Burri me kostum – (*ftohtë*)Jo,jo...

Burri me mjekërr – Si të doni!Po pse nuk mirrni një brandy?Apo doni një amaro?

Gruaja – Po ju,mos jeni gjë i zoti i shtëpisë?

Burri me mjekërr – Jo,nuk jam,madje,s'ia kam fare idenë se,kush mund të jetë, po nga përvoja, thuhet se,për shishen e uiskit mbi tavolinë dhe për gruan që të futet në shtrat,askush nuk pyet...

Burri me borsalinë – (*i drejtohet djalosht*)A mund të na sqaroni, ju lutem,më në fund, ç'ishte kjo ftesë enigmë,që grumbullon njerëz, të cilët,me sa duket, as nuk e njohin njëri tjetrin?Po më ngjan, sikur dikush na ka mbledhur qëllimisht në mënyrë konspirative,si t'ishim antarët e një organizatë terroriste, ku askush s'duhet të njohë askënd.

Djaloshi – Ja,shumë shpejt,zotëri, do t'ju bëhet e ditur gjithëçka..*(nga ashensori ka dalë një burrë me karrocë paraplegjiku dhe, me që nuk arrin t'i bjerë ziles,troket në derë. Djaloshi nxiton dhe e hap.)*Urdhëroni,zotëri!(e ndihmon të hyjë.)

(*Burri me karrocë drejton karrocën drejt sallonit.I ka kaluar të shtatëdhjetat,me flokë krejt të bardha.I përpin të gjithë me shikimin e tij të ftohtë dhe ndalet te burri me kostum*)

Burri me karrocë – Ti e ke organizuar këtë proçkë?

Burri me kostum - Jo...

Burri me karrocë – Atëherë rastësi...

Burri me kostum – Ashtu duket...

Burri me karrocë – Broçkulla! Në botë asgjë nuk është e rastësishme, e ka një shkak...

Burri me kostum – Gjithëçka do të kisha dhënë, veç të mos gjindesha me ty në një ambient të tillë kaq të ngushtë, ku, edhe po të mos dua të t'i hedh sytë, s'ke nga i rrotullon...

Burri me karrocë – Aq më bën, i hedh apo s'i hedh... Aq më bën edhe çfarë mendon ti apo shokët e tu... Është një kapitull i mbyllur për mua...

Burri me mjekërr – (*gruas*) Me linjë erdhe apo me makinën tuaj?

Gruaja – Me qerre... Po të duash kthehemi bashkë... Nuk ndahesh keq!...

Zonja – (*që ka hyrë nga njëra prej dyerve anësore dhe i drejtohet burrit me mjekërr*) Mos u shqetëso, zotëri! Do të kujdesemi ne për transportimin tuaj për në banesat e... desha të them, përkatëse... Mirëmbërëma të gjithëve! (reagime me fjalë e pa fjalë) Jam zonja e shtëpisë, apo pikërisht ajo që ju kam mbledhur sonte...

Burri me borsalinë – Ne fund të ftesës, përveç shkronjave SHPDE, që për mua janë krejt të pakuptueshme, është firma e një farë Robert M., ndërsa na dilka që na paska mbledhur një grua!...

Zonja - Unë e kam firmosur në emrin e Robert M., sepse unë mund të jem Robert M., meqë ai vetë nuk ekziston. Kisha frikë se mos, veçanërisht katër zotërinjtë e nderuar do të ngurronin të vinin, po të nënshkruhej ftesa nga një femër e panjohur... Përsa i përket zonjës (*shënon me gisht*) mendoj se gjithashtu do të ishte më interesante po të nënshkruhej nga një burrë...

Gruaja – Nga e dini këtë? Më njihni?

Zonja – Jo, thjeshtë ashtu mendova... Në fakt, duhej të kishte ardhur edhe një zonjushë e re, po me sa duket, do të jetë penduar, apo mbase është bllokuar nga trafiku... Përsa i përket shkronjave SHPDE ato përfaqësojnë katër fjalët përcaktuese për Shoqatën e Plotësimit të Dëshirave Ekstreme...

Burri me karrocë – Fillimi është i denjë për një film thriller...

Burri me borsalinë - Po kjo Shoqata juaj, në se nuk përbën sekret, me çfarë dëshirash ekstreme merret?

Zonja – Këtu nuk do të ketë më asnjë sekret... Do t'ju sqarojmë gjithçka, zotëri, sigurisht! E rëndësishme është të na plotësohen të gjitha dëshirat tona ...ekstreme! Diçka për të pirë?

Burri me kostum – Ju faleminderit! Më mirë futuni në temë, zonjë...

Zonja – Po të kini durim, gjithëçka ka rradhën e saj... Dhe, që të mos bëjmë asnjë gabim në procedurë...

Burri me karrocë – (*e ndërpret*)Mos punoni gjë gjykatëse,sekretare,apo diçka tjetër të këtij lloji,që po tregoheni kaq e përpiktë?Njihemi gjë,ne zonja... (*e thekson*) Robert M?

Zonja – Jo,nuk njihemi dhe unë nuk kam punuar kurrë në një gjykatë... Po unë them, më mirë të vazhdojmë...Po e theksoj, që të mos bëhet ndonjë gabim,e kam fjalën thjeshtë për siguri,ju lutem gjithësejçili prej jush të identifikohet(burri me borsalinë bën të nxjerrë pasaportën)jo,jo zotëri s'është nevoja për pasaportë.Emrat tuaj janë të shënuar në ftesat, që dorëzuar...Ju na thoni moshën dhe profesionin tuaj...

Burri me borsalinë – 49 vjeç,profesioni i fundit arshivist në një institucion publik...

Burri me mjekërr – 47 vjeç,drejtues i përgjithshëm i disa ndërmarrjeve private riciklimi mbetjesh urbane...

Gruaja – 38 vjeç...

Burri me mjekërr – Sa?!Unë kujtova...(e *kthen*)32...

Zonja –(*gruas*) Vazhdoni..

Gruaja – Po si të them,nuk është se kam ndonjë punë për të qënë...Bile kohët e fundit...s'kam punë fare...Gjithëçka me moshë...I duan zoçkat e reja...

Burri me karrocë – Thuaje troç, domethënë prostitutë...

Gruaja – Jo,kohët e fundit kanë filluar të na quajnë punonjëse seksi...

Zonja – (*burrit me kostum*)Po ju zotëri?

Burri me kostum – 52,sipërmarrës ndërtimi.. E,për saktësi,përveç të tjerave edhe ky bllok pallatesh,përfshirë edhe këtë që jemi,janë të mijat...Me që ra fjala,ju a jeni e rregullt me qiranë?

Burri me mjekërr – Bah,ç'rastësi!...Sikur ta dija...(burrit me kostum)Gëzohem që njihemi!Unë që në fillim pa e ditur këtë jua afrova miqësi...apo s'është kështu?

Zonja – (*burrit me kostum*)Duket që keni aq shumë pallate,zotëri,sa nuk e dini, se ndonjëri prej apartamenteve, e kam fjalën edhe për këte ku jemi, mund të jetë shitur kohë më parë...

Burri me karrocë –(*zonjës*) E thatë,e ftohtë dhe enigmatike...Tamam si një hetuese profesioniste. Keni punuar ndonjëherë në hetuesi, zonjë?

Zonja – Jo,nuk kam provuar..

Burri me karrocë – Ndërsa unë tërë jetën jam marrë me hetime e pyetje...48 vjet prokuror e gjykatës... Mijëra procese e dosje kam kaluar nëpër duart e mija...Mijëra vendime,seanca, divorce, dënime...Ndërsa ju sot po më detyroni të vihem në pozitën e një nxënësi,apo një të riu që intervistohet për të marrë një vend pune...Nuk e di ç'djall që ajo parandjenjë e diçkaje jo të zakonit,që më ngacmoi t'i përgjigjesha pozitivisht ftesës së një të panjohuri,që pastaj na del grua...

Zonja – Mirë e thatë,zoti gjykatës,parandjenja e diçkaje jo të zakonitë...

Burri me karrocë – Ka kohë që nuk e kapërcej pragun e derës, se nuk dua të takoj më asnjëri...e ndej veten keq në mes të njerëzve!...Kurse sot i pagova qimet e kokës një ambulance vetëm për të më sjellë deri këtu nga ana e anës, e përse? Për të ndenjtur prap i mbyllur në një dhomë, pa ditur përse e për të dëgjuar të flasin njerëz me të cilët nuk më lidh asgjë?...

Zonja – Në pamje të parë,zoti gjykatës!Shumë shpejt do ta shikoni, se keni diçka të përbashkët...Po gjithësesi nuk na thatë moshën...

Burri me karrocë – Po të kisha lindur katër vjet para se të më lindëte nëna ime ,do të kisha qenë plot tetëdhjetë e një vjeç..

Zonja – Dhe vërtetë po t'iu kishte lindur nëna juaj,siç e thatë, katër vjet para, plot tetëdhjetë e një vjeç do t'i kishit mbushur pikërisht sot..

Burri me karrocë –(e mbledh veten nga e papritura)Ç'datë është sot?

Zonja -Tetëmbëdhjetë shkurt...(reagim nga të gjithë)

Burri me karrocë – Ka vite që s'jam kujtuar për një ditëlindje...Për ditëvdekje po...

Burri me borsalinë – Si thatë?Tetëmbëdhjetë shkurt?Ua, vërtetë,para tre ditësh që mora rrogën,ishte pesëmbëdhjetë...Po edhe unë me tetëmbëdhjetë shkurt e kam ditëlindjen...Domethënë jo dyzet e nëntë,siç thashë qëparë, po fiks pesëdhjetë...

Gruaja – Edhe unë sot e kam!...

Burri me mjekërr – Edhe unë,për besë, po sot e kam...Sa interesant,po si na mblodhe të gjithëve...,xhanëm?(kujtohet)(burrit me kostum)I bije që edhe ju, sot ta keni...

Burri me borsalinë – (tund kokën)Paske gërmuar gjatë nepër regjistra gjendjesh civile...Nuk është hiç e lehtë në këtë qytet kaq të madh të gjesh pesë vetë,të cilët nuk i njeh, për t'u festuar ditëlindjen...

Burri me kostum – Dhe, me sa duket,paska gjetur pesë vetë,që as e kanë vrarë mendjen për një ditë tillë...

Burri me karrocë – Na thuaj motivin,zonjë apo, mbase,zonjushë...

Zonja – Zonjë...Jo, nuk ka qenë aq e vështirë sa ç'e mendoni...Unë ju njoh të gjithëve...(reagime)Një muaj më parë, u organizua një anketë me njerëz të moshave, gjinive,profesioneve të ndryshme me temën:Jeta dhe vdekja...Ju kujtohet?(reagime)Ju të gjithë ishit pjesmarrës në këtë anketë dhe, sigurisht në mënyrë konfidenciale e duke kërkuar nga anketuesit që të ruhet anonimati,keni shprehur mendimet tuaja...Pjesëmarrës në këtë anketë ishin shumë,gjithësej 22651vetë,nga të cilët 358 shprehën mendimin,se ishin vërtetë të lodhur nga jeta dhe se nuk e kishin fare për gjë ta jepnin atë,në rastin më të parë...Unë iu përzgjodha juve në mes tyre,meqenë se kishit lindur në një ditë,që...

Burri me karrocë – (*e ndërpret*)Keni shkelur privacinë dhe keni prishur kontratën...

Zonja – E di,keni të drejtë,por menduam, se kontrata dhe privacia nuk do të kishin më asnjë vlerë,nëse,të nderuar miq,për ju këto do të ishin çastet e fundit të jetës..*(reagime)*

Burri me borsalinë – Ju lutem spjegohuni pak më qartë...

Zonja – Sigurisht...Në anketën e sipërpërmendur,ju të gjithë keni shprehur neverinë dhe përbuzjen për këtë jetë si dhe gadishmërinë për ta lënë një orë e më parë këtë botë... Meqenëse edhe unë personalisht mendoj njëlloj si ju, kam organizuar këtë cocktail e më pas edhe një darkë lamtumire, që kjo dëshirë t'u plotësohet...Masat janë marrë për gjithçka deri në detaje...Mbetet vetëm të pohoni ose të mohoni atë që keni thënë...

Burri me kostum – Ju thatë se keni menduar gjithçka në detaje...Nga e dinit se nuk do të mungonim?

Zonja – I besova instinktit të gruas,që është shumë i fortë...*(burrit me mjekërr)*Mos deshët të thonit diçka, zotëri?

Burri me mjekërr – Në se edhe të tjerët kanë pohuar,ashtu si unë, se duam të ikim nga kjo jetë një orë e më parë,sigurisht që ne nuk jemi kalamaj...Veçse na erdhi disi e papritur, ndoshta, jemi ca të papërgatitur për këtë...

Zonja – Kurrë nuk është vonë të tërhiqeni,zotëri...Ju mund ta bëni në çast këtë,sa nuk është kyçur e dera e zotëria*(tregon djaloshin)* nuk është larguar...

Burri me mjekërr – Po,si kështu,tak fak si të ishim zogj pule!..

Zonja – Aspak tak fak!Po lehte e lehtë,duke ngrënë e duke pirë,duke folur e duke qeshur,pa dhimbje,pa vuajtje, si më të mirët...

Burri me mjekërr – Po të tjerat?!E kam fjalën për ceremoninë e...

Zonja – Gjithëçka është menduar...Ju nuk duhet ta vrisni mendjen...

Burri me kostum – *(burrit me mjekërr)*Me këtë rast gjen edhe makinë për në banesën...e fundit!

Burri me borsalinë – Lindur e vdekur në të njëjtën datë!...

Burri me kostum – Sikur na e ke rritur si shumë pazarin,zonjë...Në mos qofsha i gabuar edhe Shekspiri ka lindur e vdekur në të njëjtën datë,23 prill...

Burri me karrocë – A nuk është ndërtuar bota nga një mori apo zinxhir rastësish, përmes së cilave pastaj ndodh ajo që duhet të ndodhë domosdoshmërisht? Si spjegohet që në qindra mijra njerëz që ecin në rrugë e nga qindra mijra makina,vetëm njëra prej tyre vjen e të përplas,tamam në çastin kur ti sapo del nga një ëmbëltore?A nuk është rastësi që në dhjetra dyer të mëdha e të vogla të rrugicës, në mes shumë rrugicash të tjera,një qen i braktisur, apo, një tjetër,që i ka ikur të zotit, vete e zgjedh pikërisht derën tënde, që të pshurrë?! Po kështu edhe ne...Të gjithë kemi marrë pjesë rastësisht në anketë... Rastësisht zonja ka përzgjedhur emrat tonë,rastësisht unë po

mësoj se paskam patur të njëjtën datëlindje (*burrit me kostum*)me një mikun tim të vjetër...

Burri me kostum – Që,po rastësisht ka njohur një nga viktimat më të veçanta të ligësisë tënde...

Zonja – Zotërinj!Rastësia apo fati,quajeni si të doni, na bashkoi sot të gjithëve... Do të kemi kohë edhe të sheshojmë ndonjë kontradiktë...Është e nevojshme të vazhdojmë me procedurën...

Burri me borsalinë – Unë i mbetem fjalës që kam thënë...Njeriu mbase prej kohësh struk në vetvete një qëllim të fshehtë,që ngre krye herë pas here dhe pastaj vjen një çast që gjendet një pretekst për ta realizuar...Jam gati!...

Zonja – Në se nuk e keni problem,a mund të na e thoni përse?

Burri me borsalinë – Jam i zhgënjyer me vetveten!Unë,sigurisht që kam arësyet dhe shkaqet e mia,po, ma do mendja, shumë kush në këtë botë,qoftë edhe për një çast të vetëm,kanë shfryrë me fjalët: “Jetë qeni!”A nuk kanë dashur të thonë me këtë, se janë mërziur e rraskapitur nga kjo botë? A nuk kanë menduar, madje,edhe t’ia heqin vetes, apo të hidhen nga ura a dritarja e të bashkohen me të shumtët? As ftohtë,as ngrohtë, as dhembje...

Burri me kostum – (*me ironi*)Kaq shumë të paska lodhur jeta e një arshivisti?...Brenda në zyrë,qetë-qetë,me turrën e dosjeve përpara, pa t’u ngatërruar askush nepër këmbë...

Burri me borsalinë – Kur u prezantova në fillim,thashë: arshivist në një institucion, profesioni i fundit...Po kam punuar si mësues fshati,inspektor arsimit,deputet...

Zonja – Pse nuk e vazhduat politikën?

Burri me borsalinë – Nuk e përballoja dot...Nuk ishte për mua politika...Isha gatuar ndryshe...Gjithëçka e merrja seriozisht...Për të realizuar një qëllim,ka vetëm një rrugë të drejtë,siç është çdo drejtëz, e pastaj shumë të shtrembra e të tërthorta...Unë zgjidhja gjithmonë të parën dhe dështoja,vetëm dështoja... Në çdo hap ndeshja në buzëqeshje të shtira, në dredhi, ankth, pabesi, frikë... Përpiqesha me gjithë shpirt të bëja diçka për të tjerët... Se vetëm e mira për të tjerët mbetet pas teje;ajo që kemi bërë për veten tonë,vdes bashkë me ne...Po me gjithë dëshirën e mirë,dështova...Më përqeshën,u tallën me singëritetin tim,më shihnin e më tregonin me gisht si të isha një fosil prehistorik...Jeta gjithëmonë është përcaktuar si luftë...Po si t’ia bëja unë, që isha e jam paqësor?!Në luftë shkohet me armë në dorë,apo jo?...Unë kurrë në jetën time nuk kam patur një armë...kurrë nuk kam shkrehur një armë, madje as edhe një çifte, apo armë tjetër gjahu...U zhgënjeva,u tërhoqa...u dorëzova...Ndoshta pikërisht atëkohë më shkrepiti idea të zhdakesha nga kjo botë...Dhe provova...Nuk më eci...

Burri me mjekërr – Keni provuar vërtetë?Po si,kështu?Ç’bëre,si shpëtove?A ishte e dhimbshme?

Zonja – Tani nuk ka rëndësi...Natën e kemi përpara dhe ju mund të gjeni rastin të futeni në detaje..*(burrit me borsalinë)*Pastaj filluat punën e re?

Burri me borsalinë –Jo...kjo ndodhi pasi me iku Laura...

Burri me mjekërr – Laura?Kush ishte Laura?

Burri me borsalinë – Ime shoqe...E dyta...

Burri me mjekërr –E dyta?Po me të parën ç'ndodhi?Vdiq?

Burri me borsalinë – Jo, Kishtë bërë të njëjtën gjë ca vite më parë,kur punoja si mësues...Më ndrroi për shoferin e autobuzit...

Burri me kostum – Po Laura?

Burri me borsalinë – Me shokun tim më të afërt...Madje nuk mori pjesë as në varrimin e s'ëmës, se ishte degdisur diku me atë...

Gruaja – Kuçka!Ajo paska qenë më rruspije se unë...Unë të paktën, e kisha nga halli... E pranoja...Unë punoja... S'paske patur fat me gratë, o i mjerë!Dy herë!...Po, a thua vetëm ato e kishin fajin?

Burri me borsalinë – Nuk e di...

Gruaja – Si nuk e di?!Ti duhet ta njohësh veten!...

Burri me borsalinë – Ndoshta nuk e njoh...Ndoshta nuk jam tipi i duhur...Jam një dështak...Ndaj u mbylla në atë zyrë...Doja të isha vetëm...Vetëm me shkresat e dosjet...Vetëm me vetëminë time... *(Zonjës)*Unë jam gati!Kur s'ke ç'të japësh apo marrësh më nga jeta,pse duhet munduar e stërmunduar! Më mirë me të shumtit...

Gruaja – Edhe unë jam gati!

Burri me karrocë – *(në mënyrë cinike)*Po ti a e njeh veten?!

Gruaja – *(me ironi)*Siurdhëron,zoti gjykatës!E njoh,po,me sa duket, vetja nuk më njeh mua!..

Burri me karrocë – Qenke e lezetëshme!Bën edhe lojra fjalësh!

Burri me kostum – Lëreni tjetrën të flasë...Dhe mos bëj gjykatësin këtu!Në këto metra katror betoni ne të gjithë jemi të barabartë...Nuk hyjnë në sy as vitet e tua mbi dosje e vendime gjyqi,të drejta apo të padrejta,as milionat e mia!...

Burri me mjekërr – Ooo,my God!Mua më dridhen leqet e këmbëve, kur shoh një pesëshe apo një dhjetëshe,tjetri nuk e ka për gjë të të përmendë milionat...Ky është kulmi!...

Burri me karrocë – *(ironik)*Jeni me fat!

Gruaja – E di, se shumë shoqe të mia i gjen të therura si bagëtitë,të masakruara barbarisht ,të hedhura kanalesh e të fshehura pyjeve,me trupa të shqyer pastaj, nga bishat..Unë ku ta gjej këtë privilegj,honorevole,përveç të tjerash,edhe se,në këto çaste kaq të veçanta, kam nderin të njihem me zotërinë tuaj...

Burri me karrocë – Fjalë mjaft të goditura e gjuhë e mprehtë për nivelin e përfaqsimi... Po unë e kisha fjalën gjetkë...Jo vetëm për ju..Po për ne të gjithë...(zotërisë me kostum) Kuptohet edhe për ju!...

Burri me kostum – Sigurisht,desh fati,apo zonja, që na mblodhi sonte,sepse,siç edhe besoj nuk ke harruar, na lidhin ca hesape të vjetra,që edhe mund t'i sqarojmë para, se të mbarojë vallja...

Burri me karrocë – Do të kemi kohë edhe për këtë, i dashur,po ju me lini të them atë që desha të them...(të gjithëve)E dini pse jemi me fat ne të gjithë?Jua them unë.Së shpejti do të ndodhë kataklizmoja...E ç'humbasim ne,në se biletën për atje(*bën me shenjë duke nënkuptuar botën tjetër*) e premë vetëm pak kohë më parë?Po ne nuk do të shohim tmerrin që do të ndodhte para syve tanë...përkundrazi,kemi shansin të shuhemi pa e kuptuar,siç tha zonja,duke ngrënë,duke pirë, duke biseduar me njëri tjetrin për shtatë palë qejfe(*burrit me kostum*)qoftë edhe për“sqarime hesapesh të prapambetura”,i dashur...Qetë,qetë...Me muzikë...Le pastaj që rehatohemi në botën tjetër pa u ngutur...

Burri me kostum –Sigurisht, në ferr,se vetëm aty e ke vendin...

Burri me karrocë – E ku i dihet,sot?Mbase na bie për hise atje ndonjë mik, që na siguron një qoshk të mirë,para se të turret për në atë botë gjithë njerëzimi njëherësh...E, po na qëlluan vendet afër,e vazhdojmë atje bisedën edhe “për hesapet e vjetra”...

Zonja – (*gruas*)Vazhdoni!...

Gruaja – Jam e bindur, se dikush këtu do të më gjykojë sipas midesë së tij e do të më masë me kutin e tij...Aq më bën!Aq më tepër sot...Nuk e zhbëj dot të kaluarën time... Nuk kam ku t'i fsheh e ku t'i çoj plot njëzet e katër vjet jetë të shthurur...

Burri me mjekërr – Njëzet e katër vjet?!(*bën llogari me mend*)I bie ta keni nisur “punën” shumë heret,që katërmëdhjetë...

Gruaja – Atëherë nuk qe punë...Atëherë qe veç një budallallëk moshe,një lajthitje,një turbullim ndjenjash, që e bëri të dorëzohet aftësinë e vetëkontrollit...

Burri me karrocë – Kushedi çdo të shkruajnë nesër gazetata për ty...

Gruaja – Nesër askush nuk do të flasë për mua,madje do të gëzohen...Iku një lavire,do të thonë...(gjykatësit)Gjithë media do të çalltisë të mbledhë fakte për ty,o qyqar,do të shtrydhin trutë me gjithëfarë hamendjesh,të vërteta e të pavërteta...Kushedi sa histori do të sajohen e ç'nofka do të të vënë...(burrit me kostum)Edhe ti do t'u nxjerrësh punë!..

Burri me kostum – Sinqerisht po më habit mprehtësia juaj...Keni mbaruar gjë shkollë?

Gruaja- Kembrixin!

Burri me mjekërr – Vërtetë? Si është e mundur?

Gruaja – Kembrixin e rrugës! Pa shkëputje nga puna!.....

Burri me borsalinë – Ju flisni bukur!...

Gruaja – Dikur i doja librat...Lexoja me etje...I gjeja ku të mundja...Më shumë m'i jepte një mësues i vjetër në pension,që rrinte aty pranë nesh i vetmuar,i braktisur nga fëmijët. Unë stërvidhesha me vrap t'ia largoja pak vetëminë,i bëja edhe ndonjë shërbim të vogël dhe ai më jepte për të lexuar libra,që unë thuajse i përpija...Sikur përpiqesha të gjeja në to psetë për shumë gjëra që jeta,fati,apo rastësia m'i kishte sjellë njëherësh pa pikë bujarie...Pse,ta zëmë,pikërisht mua,më kishte zgjedhur për prindër dy qenje, që veç i nxirrnin sytë njeri tjetrit natë për natë,me sharje e fyerje, që të dhimbnin veshët t'i dëgjoje?Pse më kishte detyruar të haja natë për natë po ato krodhe buke me turshi a mastardë e të shpoja hundët nga avujt e rakisë, që shpesh edhe derdhej për tokë?Pse më duhej mua pikërisht,një kërthie të njomë,t'u hyja në mes për t'i ndarë, jo rrallë duke u përplasur për tokë nga të shtyrat e tyre? Këto e shumë pyetje si këto përpiqesha të zbuloja përmes librash,që në atë kohë ishte kënaqësia ime e vetme...Kur më vdiq babai,nuk qava,edhe pse u shtrembrova sa munda të derdhja lot...Kur vdiq miku im plak,një muaj më pas,u dënosa si për të nxjerrë jashtë bashkë me dhimbjen edhe dufin që më ishte mbledhur prej kohësh si gulç...

Burri me mjekërr – E shkreta, ç'paska hequr!...

Burri me borsalinë – Po pastaj?!

Gruaja – Pastaj nëna u martua prap dhe ne shkuam në shtëpinë e njerikut...Ca kohë, sikur ndërroi për mbarë...Ndërkohë rritesha...Kisha hirin dhe freskinë e një gonxheje në shpërthim...Dhe ndodhi ajo që ndodhi...

Burri me karrocë – Kush, njeriku?

Gruaja – Jo...

Burri me mjekërr – Atëherë komshiu...

Gruaja – As komshiu...Ishte thjeshtri i nënës time apo për ndryshe,vëllai im i gjetur... Ishte një vit më i madh se unë...Po rriteshim nën një strehë...dhe shkonim mirë...Gjithë ditën bashkë...luanim,ziheshim...Më fliste për ëndrrat e tij...Donte të bëhej kineast... Ndofta atëherë më lindi thellë në shpirt dëshira për t'u bërë aktore...Flisnim, luanim, ngacmonim njeri tjetrin...Mirëpo një ditë i "kapërcyem kompetencat"...Pastaj, se ku u zhduk e nuk u bë më i gjallë...E vuajta shumë largimin e tij...Ishte i vetmi njeri, që kisha filluar të doja vërtetë...

Burri me karrocë – Po njerkun?

Gruaja - E respektoja...Ai më donte shumë...Edhe më përkëdhelte ndonjëherë, po kur nisa të formohesha, sikur u tërhoq pak...Nuk e di në e mori vesh apo jo se ç'ndodhi ne

mes meje dhe të birit...Asnjëherë nuk më dha të kuptoj ndonjë gjë...Veçse kishte filluar të më shihte disi ndryshe...Fillova të ndihem ngushtë nga vështrimi i tij...Po kurrë nuk më dha shkas, deri sa unë ika nga shtëpia...

Burri me mjekërr – Ç’deshe që ike?Mirë ishte aty!

Gruaja – Hë pra,ç’desha që ika?!Tamam - tamam as sot nuk e kam një përgjigje të saktë... Veç di,se më mirrej fryma në atë shtëpi të zyrtë e të vockël sa një kuti shkrepseje, me mure të mbuluar nga një letër e shëmtuar në gri e errët, e nxirë edhe më nga tymi dhe zhuli...,një shtëpi, që u ngushtua edhe më nga ardhja e njëpasnjëshme në jetë e dy fëmijëve të tjerë,të cilët s’bënë gjë tjetër, veç shtuan alkolin e sime mëje dhe heshtjen e tim njerku... Unë rritesha në atë kuvli dhe zbukurohesha... Mos më shikoni sot...

Burri me borsalinë – Mos flisni ashtu, zonjë,ju edhe sot jeni e bukur...

Gruaja – Tashmë jam kthyer me këmbë në tokë,zotëri,nuk fluturoj më, si atëherë...Tash nuk më bën më përshtypje, qoftë edhe një fjalë e mirë, e thënë sinqerisht...Kjo (*tregon fytyrën*) është vetëm vula e një rinie të çuar dëm; në fillim, në kërkim të një limani për varkën time të çoroditur nga dallgët,në kërkim të një ishulli, ku të hidhja sperancën e ëndrrave të mia...Kisha një botë plot me ëndrra e dëshira... E doja jetën... Po ma shfrytëzuan barbarisht,pa mëshirë,herë njeri e herë tjetri,vetëm për të ngopur epshet e tyre të pangopura ...Doja të bëhesha dikushi!...Isha si një gazelë e mjerë,e porsa ndarë nga tufa,që shetit e shkujdesur pyllit mahnitës,kur befaz rrethohet nga një lukuni ujqish të uritur,që i sulen për ta shqyer...Më joshën me fjalë të bukura,që më pëlqenin,iu vërsula karremit që më hodhën...Ballove,salloneve,jahteve,darkave dhe suitave me klientë të ndryshëm,plot tollumbace premtimesh...Përfundimi?Një prostitutë me P të madhe,që vyshket dita ditës duke shitur “mallin” e saj,tashmë pa botë,pa ëndrra, pa pasion,bosh,e pa vlerë, si një shuk i hedhur kartpecetash...Ajo nuk sheh më asnjë dritë së largu, nuk ka asnjë arsye për të vazhduar më tej, asnjë motiv...E si mund të ketë kuptim jeta pa këto?!...

(shkon tek minibari hedh ca uiski dhe e kthen me të shpejtë. Burri me mjekërr i afrohet)

Burri me mjekërr – Hidhmë dhe mua ca!(e kthen gotën e uiskit)Eh!Të ndryshme i kemi telashet,po të gjithë,me sa duket, njëlloj jemi...(shkon tek dritarja)

Burri me karrocë – Të gjithë jemi minj të një anije, që po mbytet...Të gjithë!...(burrit me kostum)Sigurisht,edhe ti nuk bën përjashtim!

Burri me kostum – Është e habitëshme,se si mund të vazhdosh të jesh kaq cinik me njerëzit, edhe pse shumë prej tyre ti i ke bërë të vuajnë,u ke vrarë ditët,muajt vitet...

Burri me karrocë –Nuk jam penduar!Kam zbatuar pikë për pikë ligjin!Edhe pse,(e thekson) në ndonjë rast,nuk ka funksionuar...Megjithatë,kurrë nuk mund të bindësh një njeri të besojë atë, që nuk dëshëron të besojë...

Zonja – Zotërinj! Ju lutem! Le ta ruajmë qetësinë e nevojëshme, për raste të tilla... Sonte vërtetë, është nata e rrëfimeve të singërta, e çlirimit shpirtor, madje edhe e sqarimeve për çështje, që ndoshta nuk e kanë bërë vitet... Po me qetësi dhe pa fyer njeri tjetrin...

Burri me mjekërr – Mirë e ka zonja! Fati na mblodhi të gjithëve... Nuk kemi pse nxehe mi. Ne po i rrëfijmë njëri tjetrit gjëra, që as natës së varrit s'do t'ia thonim...

Burri me borsalinë – Jo, në fakt nata e varrit është sonte!.. Dhe, me që ra fjala, ti nuk na ke treguar asgjë...

Burri me mjekërr - Pika!.. Të bukura gjëra, që kam për të treguar!.. Hë, e gjen kush hallin tim? Nuk e gjeni? Ju a them unë! Qeni qepë të hajë! Ç'ju thashë në fillim se isha? Manaxher? Gënjeva!... Pse, do thoni ju? Se nuk ju njihja dhe se nuk e dija pse ishim mbledhur... (*kthehet nga burri me kostum*) Tash, që u bëmë tanët, dëgjoni mirë: Isha menaxher, vërtetë... I mblodha dy groshë para me djersën e ballit... Nisa një biznes... Fillova të ngjitesha shkallë - shkallë.. Ani, pse më të zotët ngjiteshin me ashensor!.. Ani! Unë nuk e vrisja mendjen.. Nuk i kisha zili... Unë prap shkallë-shkallë... Veç përpjetë.. Siç thonë, urtë e butë e plot tiganin!... Eee, sa bukur ishte ta shihje botën që lart! U bëra njeri... Vura ca dhjamë!... Rregullova edhe dhëmbët me flori!... Po do ti, që tamam atëherë m'i mori zoti mentë? Kujtova se kapa qiellin me dorë dhe u lëshova pa frena...

Burri me karrocë – Kësaj i thonë, kishte rënë ari në dorë të kovacit!

Burri me mjekërr – Edhe më zi!.. A thua se mu shpua dora! Ç'pata e ç'nuk pata i bëra të gjitha rrush e kumbulla... Pa le, pa, zura edhe dashnore!... Ajo sikur s' kishte dy duar, po dy kova eskavatori! Veç kur e pashë veten nën zero!... Thellë e më thellë... Rropatu majtas e djathtas, kapu këtej e kapu andej, rrëshqita teposhtë, si të isha në një kodër të pjerrët mbuluar me akull... Kaq!

Gruaja – Vetëm kaq?

Burri me mjekërr – Kjo ishte gjysma... Kur nuk kisha mjekërr... Gjysma tjetër kur lëshova mjekërr..

Burri me karrocë – U kape për mjekërr e shpëtove?

Burri me mjekërr – Kush tha? Mjekrra më shpëtoi për ca kohë, deri sa ma mësuan marifetin.. Tani e mbaj kot! Nuk pi më ujë!... Kam ndrruar tre autobuzë deri sa erdha këtu... Më ndjekin gjithandej...

Burri me borsalinë – Kush?

Burri me mjekërr – Si kush? Po njerëzit, o njeri, që u thava xhepat! Herë njerit, e herë tjetrit... Një mal me borxhe!... Ua nxiva jetën atyre të shtëpisë... Po tani kam ikur nga shtëpia... Kam bërë edhe gjasme divorc me gruan... Kam ndrruar edhe mbiemër... Po prap se prap, s' kam ku të fshihem më...

Burri me borsalinë – Kërko të hysh në burg!

Burri me mjekërr – Aty do të rrinë ata, tek dera e burgut, si statuja të më presin deri sa të dal... Jo, jo, nuk ka vend më të sigurtë se bota tjetër.. Megjithatë kam frikë, se edhe atje do të ndesh në ndonjë nga ata fakirët!...

Burri me karrocë – (*zonjës i tregon me shenjë burrin me mjekërr*) Zonjë, në emër të mikut tonë, bëni çmos t'i gjeni një kostum! (për burrin me kostum) S'ka gjë, në mos qoftë si i zotërisë!.. Nuk shkohet në atë botë me xhinsa e xhup sportiv!...

Burri me mjekërr - Kush e vret mendjen? Pse, mos do të vinë njerëz në varreza për mua? Të gjithë ish miqtë e mi më ndjekin... Nuk ma do mëndja të vijë ndokush të më përcjellë... Edhe në se qajnë, qajnë paratë e tyre, jo mua...

Burri me borsalinë – (*i afrohet gruas që është tek dritarja*) Vazhdon fortuna?

Gruaja – Për shtatë palë qejfe! Gurë rënçin sonte!

Burri me borsalinë – Jo zonjë, mos flisni ashtu... Kjo botë ka shumë të pafajshëm!..

Burri me karrocë – Të fajshëm e të pafajshëm, në pluhur do të kthehen të gjithë... Ec e dalloji pastaj njërin nga tjetri...

Burri me kostum – Dallohen... Tjetër ngjyrë ka hiri i drurit të lisit nga ai i qymyrit të gurit. I yti nxin aq, sa të mos e ngatërrosh kurrë...

Burri me karrocë – Sonte paskam shumë qejf, t'i lë të tjerët të nxjerrin tërë dufin e vrerin, që i ka munduar kot kaq gjatë...

Burri me kostum – Si thatë, kot?!

Burri me karrocë – Po, kot thashë. Kot, si ai rrebeshi përjashta, që mund të kursente ca tonelata shi për ndonjë stinë të thatë.. Shfren, shfren, po do të shtrasin retë e shiu do të pushojë... Edhe ti do të paqtohesh e shkoni andej, ku je nisur, pa mllafe... (*burrit me borsalinë*) A duket që aty Pallati i Drejtësisë?

Burri me borsalinë – Nuk e dalloj... (*gruas*) Po ju, zonjë, e dalloni?

Gruaja – Jo. Vetëm Banka Kombëtare dallohet...

Burri me kostum – Nuk është Banka Kombëtare... Është B&J...

Burri me mjekërr – Kaq i sigurtë je pa e parë? Ke gjë atje?

Burri me kostum - Edhe aty kam një pjesë të aksioneve...

Burri me mjekërr – Që duhet të jenë miliona!

Burri me kostum – Sigurisht!

Burri me mjekërr - Ky është kulmi! Dhe doni t'i brakstisni të gjitha?!

Burri me kostum – Nuk më hyjnë në sy. U lodha me shifra, makinacione, hilera monetare, shantazhe, presione, transferta, gjyqe... Kam kaluar aq shumë para nepër

duar, sa nuk ia di më vlerën...Tek e fundit letër është...Letër me ca dizeno e kode sekrete, që çmend dynjanë!..E kam filluar me disa centë, po e mbyll me miliona...S'kam asnjë motiv,për të vazhduar më gjatë...S'kam më asnjë kuriozitet...Kam arritur kulmin,dhe kur ke kapur majën, pastaj fillon tatëpjeta...Nuk më pëlqen tatëpjeta!.. Më mirë të më mbajnë mend njerëzit në majë!...

Burri me mjekërr- Si thatë,miliona?Dhe nuk kishit asgjë të trashëguar?

Burri me kostum – Asgjë...Një apartament me pak metra katrorë si i njerkut të zonjës (*bën me shenjë për gruan,që vazhdon të qëndrojë pranë dritares me burrin me borsalinë,duke i treguar njeri tjetrit me gisht godina të ndryshme të qytetit*)dhe një kone...

Burri me mjekërr – Po ti qenke gjeni!..

Burri me karrocë – Ose i çmendur!Vetëm një fije peri e ndan gjeninë nga i çmenduri...

Burri me kostum – Ti gjithëmonë flet e sytë i fsheh.Tërë jetën i ke fshehur sytë për të mos treguar ç'zjen në vorbën tënde...Unë e di mirë, se ç'të mundon...Dhe ti e di që unë e di!Më fole pak më parë për mllëfin e vrerin...Mos po përpiqesh të lehtësosh shpirtin,duke i rënë patkoit në vend të gozhdës?

Burri me karrocë – Jo...Përvoja e jetës ma ka ka mësuar dorën të godas mirë, siç duhet e ku duhet!

Burri me kostum – Të paktën në një rast, që ne të dy e dimë,apo jo,u përpoqe të godasësh gozhdën, po coptove gishtin...

Burri me karrocë – Gozhdën e kishin lyer me lubrifikant dhe i rrëshqiti të goditurës... Ishte faji i gishtit,që gjendej në vendin e gabuar...

Burri me mjekërr – Më falni që po ju ndërpres, po ju po silleni anës e anës rreth diçkaje, që edhe na thuhet edhe s'na thuhet.. Ndoshta,meqë u bëmë si tanët, do të na e sqaroni më vonë,apo jo?... Unë për vete po ngordh nga kurioziteti të di, se si një goxha milioner,që, mbase, nuk di tamam tamam as sa ka,vendos të ikë nga kjo dynja pa pikë zori, pa vrarë mendjen, se kush do të jetë ai fatlum,që do t'i gëzojë... Vërtetë ke vendosur të çalltisësh në atë rrugë pakthim?

Burri me kostum – Po.A nuk jemi të gjithë të vdekshëm?A nuk na rri vdekja në pritë që kur lindim?A nuk është fshehur ajo pas një ataku të papritur në zemër,pas një aksidenti, pas një sëmundje të gjatë e të pashërueshme,pas një thike që të ngulet pas shpine, kur prisje një përqaftim?Është hall të vdesësh, kur do të jetosh...Në rastin tim është krejt e lehtë:dua të vdes,se nuk dua të jetoj!...

Burri me mjekërr – Po,pra,po unë këtë s'po e kuptoj!...

Burri me kostum – Është fare e thjeshtë...S'kam më asnjë motiv për të vazhduar më gjatë...

Zonja – Grua,fëmijë?

Burri me kostum – Jo...

Gruaja – Kësaj i thonë, kur ka qumësht në pazar, ç'të duhet lopa në shtëpi!...

Burri me kostum – (vë *buzën në gaz*) E thatë bukur zonjë... Pikërisht ashtu!

Burri me mjekërr – Të ndash jetën me dikë, është bekim! Po nuk thonë kot, fati i keq rri pezull në ajër deri sa i bie dikujt mbi kokë!... Po ku vajti e më gjeti mua! Ah, ç'i bëra vetes!

Zonja – (*burrit me kostum*) Po thonit që...

Burri me kostum – Po thoja që, nga njëra anë stresi i përditshëm e torturues...

Burri me mjekërr – (*e ndërpret*) Po ti tërhiq nga puna, o derëzi! Rri në shtëpi! Bridh botën... Ik, ik, o vëlla, shko, bëj pallë!...

Burri me kostum – Të bredh botën? I kam rënë kryq e tërthorë botës.. Ku s'kam qenë! Ku lind e ku përendon... Edhe në Taj Mahal, edhe në Niagara, edhe në xhunglat e Afrikës, edhe në Kapagabana Beach, edhe në Grand Canion, edhe në Tibet e Jerusalem! Kudo! Nuk më hyn në sy asgjë... Ia kam pirë lëngun gjithçkaje... Më është velur gjithçka. .. Nuk kam ç'ti marr më kësaj bote, e merr vesh?... Kurioziteti i vetëm që kam, është bota e përtejme... Më mirë, po nxitoj për atje, se mos gjej një vend të mirë, siç thotë zotëria (*për gjykatësin*), sa nuk janë turrur të gjithë sëbashku...

Zonja – Kaq?

Burri me kostum – Kaq. Pse, nuk mjafton?

Zonja – Po të mos ketë gjë tjetër...

Burri me kostum – Nuk ka gjë tjetër!...

Zonja – Mirë, me që thoni ju!... (*pauzë*)

Burri me karrocë – (*u hedh një shikim të gjithëve me rradhë*) Më erdhi rradha?! Po prisni t'u rrëfej gjërë e gjatë, pse kështu e pse ashtu? Mos u mprehni kot, nuk kam shumë për të thënë... E dini pse? Sepse ju quheni njerëz! Ndërsa unë nuk e ndjej veten mirë në mes të njerëzve... më krijojnë ankth.. Po, po, ankth! Më mbyt prania e njerëzve... Në jetën time të gjatë kam parë e gjykuar shumë, të njohur e të panjohur, të afërm e të largët, kriminelë e kopukë, hileqarë e dredharakë... Eh, ç'barrë të rëndë kanë mbajtur për dekada të tëra këto shpatulla! Nuk e shikoni si janë krrusur? Edhe peshën e presionit për të ndryshuar vendimin, edhe shantazhin për të shtrembruar ligjin, edhe kërcënimin me jetë... Kam njohur politikanë, që kanë dashur të më bluajnë, si në një gur mulliri; kriminelë që më kanë ndjekur si hijena, gazetarë me emër e anonimë, që me zell për t'u patur zili, kanë shpalosur gjithë arsenalin e njohurive të tyre leksikore, në garë për të gjetur kush e kush më shumë epitete fyese e poshtuese... (*politikani është afruar si i shokuar nga fjalët e gjykatësit*)

Burri me borsalinë – Më falni, që ju ndërpres, zoti gjykatës, po ju, mos jeni...

Burri me karrocë – Unë jam, unë, i pathyeshmi, i serti, i ngurti, pseudoheroi, Justiniani I i drejtësisë, i çmenduri, zemërguri, kali i karrocës...Do më?

Burri me borsalinë – Kam dëgjuar shumë për ju...Ju, në atë kohë ishit prokuror, apo jo? Unë ju vlerësoj thjeshtë si një legjendë!.. Dhe, të mendosh, se po ju takoj sot në rrethana të tilla!...E habitëshme! Po ju betohem, unë ju kam mbështetur me gjithë shpirt në procesin e bujshëm të ngritur kundër ministrit të drejtësisë, i quajtur nga media, në mos u gabofsha “Togat e përlyera” Në atë kohë isha deputet...Më besoni! Unë nuk zë be kurrë, por po ju betohem!..

Burri me karrocë – Nuk do t’ju falenderoj për këtë!

Burri me borsalinë – E tmerrëshme të mendosh, se krimi ishte aq i dukshëm nga të gjithë, përveç gjykatësve...

Burri me karrocë – Mos u çudisni! Ishte detyra ime për t’i gjetur e paraqitur provat, ashtu siç ishte detyra e atyre, për t’i fshehur, apo, në rastin më të mirë, për të mos i parë...

Gruaja – E hu, ha, ku ka drejtësi! Në ato që ne quajmë “tempujt e ligjit”, po të dojë gjykatësi e kthen dardhën në pjepër!...

Gjykatësi – Jooo, mund ta lejë edhe dardhë! Po dardha është edhe e gjelbër edhe e verdhë...Zgjidh e merr!

Gruaja – Po, po, veç, po të isha unë në vend të Ministrit të Drejtësisë...

Burri me karrocë – (e ndërpret) Po të ishe ti në vend të Ministrit të Drejtësisë, ende do të vinte era kalbësirë në birucë!...

Zonja – Po një figurë si ju, nuk duhej të thyhej, duhej të bënte qëndresë deri në fund!...

Burri me karrocë – (nënqesh) Kam njohur një herë e një kohë një jurist të ri, që mendonte tamam kështu si ju... që ëndërronte e përbetohej të mos dorëzohet kurrë, deri sa drejtësia të vihej në vend, që njihete si në pëllëmbë të dorës me pikë e me presje nenet e ligjet, të mësuara nga librat e leksionet, që përpiquej të mos harronte kurrë, se simboli i drejtësisë është balanca...Po ku shkoi ky djalosh? Vdiq? Ia bluan eshtrat? Do të doja tani ta kisha përballë e të bisedoja me të...Do të ishte shumë interesante, të dëgjoja tani, se ç’do të thoshte ai për për të dënuarit e pafaj, e për fajtorët e padënuar... Do të doja ta pyesja, mos vallë nderi ishte një këmishë shtati!...

Burri me kostum – Tërë jetën ke gjykuar të tjerët...Lëri tani të tjerët të të gjykojnë...

Burri me karrocë – Nuk e bën dot! Nuk i njeh ligjet dhe paragjykon...Gjykatësi duhet të jetë i ftohtë!

Burri me kostum - Sepse, të flasësh për nderin...

Burri me karrocë – (e ndërpret) Të flasësh për nderin do të thotë t’ia dish mirë emrin e vlerat, edhe kur të tjerët, që mendonin të kundërtën, në rrethanat, që ju i njihni mirë, mund ta kishin përdredhur në duar, siç përdridhet e shtrembërohet një tel i butë...

Burri me kostum – O,zot,ç'njeri je!Po si është e mundur të dënosh...

Burri me karrocë –(ndërhyn) Është e mundur, po të mendosh e gjykosh si ai juristi i ri

Burri me kostum – Ajo që ke bërë ti është e paimagjinueshme,është absurde!

Burri me karrocë – A ka më absurde,se sa të shohësh ushtarët a oficerët,që, para se të nisen për në luftë,sigurisht jo për të mbledhur banane, i luten zotit të bekojë krimet e tyre?!(ndrron bisedë) U fyet pak më parë,që u thashë se njerëzit me ndjellin ankth?... Hiç mos u fyesi!.. Fatkeqësisht, edhe unë vendin në sojin e njerëzve e kam...Kurse të vdekurit janë të paqtë...janë edhe më të shumtit!..

Zonja – Përpara se të vazhdojmë më tej...(sheh nga gjykatësi)me procedurën,do të doja t'ju pyesja edhe njëherë të gjithëve: Jeni,vërtetë,të bindur,se çdonjeri prej jush, dëshëron të heqë dorë nga kjo botë,duke mos dashur të dijë më për asgjë e për askënd?Mendoni mirë për disa minuta!

(dritat.Muzikë)

Veprimi i dytë

Po e njejta skenë.Të njejtët njerëz.

Burri me karrocë –(ironik) Vazhdoni me procedurën!Mundësisht përshpejtoje atë!..Ia kam pirë lëngun aq, sa s'ka më,sidomos vitet e fundit!...(tregon karrocën)

Gruaja – Njeriu kur lind,i ka të caktuara ditët...

Zonja – Ju tani e keni vetë në dorë...Mund të dilni!

Gruaja – Që të vazhdoj të zhgryhem në llum?Jo,nuk mund ta shtyj më!...

Burri me borsalinë – Kur dëgjova të gjithë miqtë e mi të rinj në këtë dhomë,të shpreheshin për kotësinë e kësaj jete, më erdhi vërtetë keq,që kam qenë i pasukseshshëm në provat e mia të mëparëshme, se deri tani unë nuk kam bërë asgjë tjetër,përveçse ia kam shtuar vuajtjet vetes...Unë jam vërtetë shumë mirënjohës,që po më krijoni këtë mundësi të dytë...

Burri me kostum –(*nënqesh*) Si parafolësit edhe unë...Uroj të jeni e sukseshme në përmbushjen e kësaj detyre!..

Burri me mjekërr – (*si në hall*)Po si të them...

Burri me kostum – Thuaje siç e ndjen!..

Burri me mjekërr - Po...hajt,veç, me që edhe ju...(zonjës) Si të tjerët,edhe unë!..

Zonja – Që të jemi në rregull edhe me ligjin e të mos i nxjerrim andrralla policisë e prokurorisë,paraprakisht kam përpiluar një procesverbal,që e kam quajtur Akt-vetëflijimi! (*gjykatësit*)Zotëri,ju jeni specialist dhe mund t'i hedhni një sy!

Burri me karrocë – As që ma ndjen fare,se sa do të vuajë policia apo prokuroria për të hetuar në ç'rrethana e përse u gjendën disa kufoma lehtësisht të identifikueshme në një apartament X...Madje do të jetë interesante të marrim me mend versionet e tyre...

Zonja – Ju keni të drejtë të flisni kështu,pas gjithë atyre që treguat..Po kjo bëhet më tepër për djaloshin(*bën me shenjë*),që ai të mos akuzohet padrejtësisht,për diçka që ne po e kryejmë me vullnet të plotë...(burri me karrocë *sikur thyhet e tund kokën në shenjë miratimi.Zonja lexon*)

“Akt – dëshmi vetëflijimi

I mbajtur sot me aq e kaq,me anën e të cilit ne të mëposhtëshënuarit dëshmojmë, se me ndërgegje të plotë dhe pa presionin e askujt vendosëm të vetëflijohemi apo të heqim dorë vullnetarisht nga jeta.Arsyet dhe shkaqet janë vetiake e të ndryshme.Ato nuk dëshirojmë t'i bëjmë publike, por duam t'i marrim me vehte në botën e përtejme. Deklarojmë se,nuk ka asnjë rrëmbim personi, nuk jemi sjellë këtu me pahir.Gjithçka është bërë në mënyrë të vullnetëshme.Gjithësesi ajo që na bashkon të gjithëve në aktin tonë sublim është lodhja dhe pakënaqësia nga kjo jetë.Nuk ka asnjë përgjegjës apo shtytës të jashtëm në këtë veprim tonin. Personi, që do të lajmërojë organet kompetente dhe do të kujdeset për plotësimin e detyrimeve të tjera mortore, nuk është në dijeni të aktit tonë dhe nuk mban asnjë përgjegjësi për këtë. Atij do t'i bëhet e ditur me anën e një letre gjithçka,nesër me datën nëntëmëdhjetë shkurt.Vijojnë emrat.

Burri me karrocë – Kjo është thjeshtë një dëshmi.Ka vetëm firmat tona.Nuk është dokument zyrtar.Nuk ka vulë.Nuk është e noterizuar.Nuk ka asnjë vlerë juridike.Është

thjeshtë një letër. Një dëshmi, që mund të merret për bazë ose jo. Gjashtë vetë mund të vejnë një firmë edhe nën kërcënimin e një arme të drejtuar në gjoks apo një tehu thike në gurrmaz. Po ju mos e vritni mendjen! Kjo është një kryevepër! Unë që tani po shoh, se si do të marrë rrugë intriga, se si një batalion hetuesish e policësh, që presin të rriten në karrierë, do të vërsulen, kush e kush më parë të japë versionin e tij, se si gazetarët, që shansi u hodhi mbi pjatën e boshatisur mollën e Neutonit, do të mbushin me lajmin sensacional faqet e gazetave e reportazhet televizive. (*muzikë*.) Ja, unë po e firmos i pari!

(merr stilolapsin nga zonja dhe e firmos. Zonja e vendos letrën mbi tavolinën e mesit. Aty, të shoqëruar nga muzika, me një farë solemniteti, afrohet sejcili me rradhë, i hedhin një sy letrës dhe e firmosin. Burri me mjekërr heziton një herë, i sheh të gjithë, si për të marrë zemër prej tyre dhe më në fund firmos.)

Zonja – Atëherë, besoj se është normale të ngremë një gotë për marrëveshjen tonë! Do t'ju gostit me një cocktail, që kam përgatitur vetë me arrë kokosi, pjepër, rum e lëng shege. Është specialitet i familjes sonë prej vitësh... (*djaloshi sjell gotat, ajo shkon tek minibari dhe merr një shishe me bark të gjërë, u hedh të gjithëve një lloj lëngu në gotat përkatëse, pa harruar veten*) Atëherë, të nderuar miq, zoti qoftë me ne! (*dikush me njeherë, dikush në mëdyshje i ngrejnë gotat*)

Burri me mjekërr – Qenka fantastike! A mund të më hidhni edhe ca?

Zonja – Me kënaqësi!

Gruaja – Edhe mua po deshe! (*u hedh. Shishen e vendos mbi tavolinë*)

Zonja -Tani miq të mi, kush ka të dorëzohë celularët. Do të shkëpusim lidhjen me botën që po lëmë pas...

Burri me kostum – (*ja jep*) Merreni! Më ka prishur gjumin në mes të natës me lajme tronditëse, ka dëgjuar shifra, emra mallrash, përqindje aksionesh, këshilla, qortime, të shara, ftesa, refuzime, të qara... Ka qenë një mik dhe një armik i mirë!...

Burri me karrocë – Këtë celular e kishe, edhe kur dhe alarmin “Sos” për ndihmë humanitare?

Burri me kostum – Alarmi Sos nuk u dha për të shpëtuar “anijen time” dhe mua... Unë nuk isha në rrezik, se unë lundroja në ujra të pastra e të qeta... Ai alarm u dha për të shpëtuar shokët e mi, sidomos njerin, që edhe pse bëra të pamundurën, ti arrite ta rrasje brënda...

Burri me karrocë – Jo, unë, ligji! Unë dorëzoja faktet për ata të dy. Gjykata nuk i quajti të mjaftueshme faktet për kryesorin. Ajo mori për bazë vetëm ato që dënuan shokun e tij dhe.. tëndin... (*e sheh se burri me kostum matet të thotë diçka dhe ndrron bisedë*) Unë nuk kam celular, zonjë, ka vite që nuk e përdor. Sidomos, që kur mora patentën e Jaguarit tim (*për karrocën*) shumëkujt u ranë bateritë e telefonave apo u mbaruan kreditet... Kishin frikë të më mirrinin, ndoshta, edhe se mos i thirrja me ngulm për drekë a darkë, me që isha bërë i famshëm për artin tim kulinar, sidomos në fushën e vezëve...

Më tepër më dhimsen ata që përbetoheshin,se qenë kujtuar të më mirrin,po për fat të keq, nuk ndodhesha në shtëpi!Se ku më zë mua vendi vend,moj Zonjë e nderuar?! Herë për sërf e herë për ski!...Le pastaj,që ky Jaguari im fluturon,e s'pyet për borë e shi!...

Gruaja – Sidomos, kur ke pranë ndonjë bjonde tetëmbëdhjetëshe,që ta vë takën e çizmës mbi kryeskot!

(Burri me borsalinë dhe gruaja i japin të tyret pa koment.)

Burri mjekërr – (*tund kokën*)Nuk kam!Edhe atë kisha mangut!(*Zonja ia dorëzon djaloshi dhe kthehet*).

Zonja - I vetmi që do të mbesë gjallë nga ne do të jetë ky djaloshi.Ai do të kujdeset për kufomat...Nuk mund të rrinë gjatë kufomat këtu, se bien erë...Ai do të na nxjerrë e do të na varrosë të gjithëve.Ndonjë amanet që mund të keni,ose thojani tani, sa është pa dalë,ose më vonë... Mendojeni mirë, i shkruani dhe i mbani në xhep, që ai pastaj nesër t'i lexojë e t'ua plotësojë dëshirat... Amanetin nuk e tret dheu...

(pauzë.Muzikë)

Zonja – (e përqafohet djaloshin)Mund të shkoni.Siç kemi biseduar e vendosur për gjithçka. Lamtumirë!...

(tekta përqafohen, bie zilja.Zonja futet në njëren nga dyert anësore.Të tjerët shohin njëri tjetrin.Djaloshi hap portën.Hyn një vajzë e re dhe shumë e bukur.)

Vajza – (*djaloshi*)Mirëmbërëma!

Djaloshi – Mirëmbërëma!

Vajza – Kisha një ftesë! Po nuk e mora me vete,se thashë ndoshta nuk do të ishte e nevojëshme! Po ti ma hap rrugën të hyj brënda,se jam bërë qull...Besoj,se do të më pranoni edhe pa ftesë!..Se kush e merr rrugën nga ana e anës përmes një rrebeshi të tillë, po të mos kishte ftesë?!

Djaloshi – Urdhëroni brenda!Po do t'iu lutesha të dorzonit celularin!

Vajza - Posi,me gjithë qejf! (*ia jep.Ai i hap rrugë për në sallon ku janë të tjerët. Vajza drejtohet për andej.*

Djaloshi – (*u bën me dorë të gjithëve*)Natën e mirë!Zoti qoftë me ju! (*del*)

(vajza hyn në sallon.I vështron disi e hutuar ata të gjithë.I përshëndet me kokë,si për t'u thënë diçka, po sikur i është lidhur gjuha)

Burri me borsalinë – Mirëmbërëma,zonjushë!Urdhëroni uluni!(*i tregon kolltukun bosh.Ajo ulet,pa thënë asgjë,vështon shtëpinë,njerëzit.*)

Gruaja – Qenke bërë qull,moj e gjorë!Nuk mund të prisje edhe pak,sa të ikte(*për djaloshin*)stuhia?

Vajza – Kisha një orar!Kisha dhënë fjalën që do të vija!

Burri me karrocë – Për pak desh e humbe shansin!

Burri me mjekërr – (*i sjell një gotë*)Urdhëro, merre ca veten!Është një cocktail i bërë nga zonja e shtëpisë me arrë kokosi,pjepër, rum dhe lëng shege!Traditë e familjes! (*vajza e merr dhe fillon të pijë.Burri me mjekërr i hedh edhe vetes dhe e kthen*)

Vajza – Qenka shumë e mirë!Për gëzime!

Burri me mjekërr – O,lëre,mos pyet!Ku ka gëzim më të madh,se të provosh për herë parë të udhëtosh me tren ekspres,për një udhë kaq të gjatë!Biletës, që ne do të presim së shpejti, i thonë “single”, dmth,teke, nuk është “return”,shqip, pa kthim...Do më?

Vajza – (*nuk e kupton*)Jo,të faleminderit!(*ai ia merr gotën dhe largohet.Gruaja i afrohet dhe e vështron*)Pse po më shikoni kështu,zonjë?Ka gjë që nuk shkon?

Gruaja – Shumë!...Je kaq e re dhe e bukur!

Vajza – Po nuk ka ndonjë të keqe këtu,apo jo?

Burri me borsalinë – Këtu është problemi, se nuk kuptojmë, ti ç’deshe që erdhe këtu!

Vajza – Unë..erdha këtu...,si të them(*i sheh*)ashtu si edhe ju...(Hyn zonja)

Zonja – (*vajzës*) Mirëmbërëma!Qenkeni lagur!Shkoni në banjo!Keni edhe një peshqir aty e tharëse flokësh!(*e shoqëron*)

Burri me kostum – Edhe kësaj i është mërzhitur jeta?

Zonja – Nuk e di...Në fakt i është dërguar ftesa edhe një vajze të re,po...,sikur ishte ndryshe...Ja ta pyesim,sa të dalë...

Burri me borsalinë – Mos është gjë gazetare?Mos keni lajmëruar gjë median dhe ata e kanë dërguar për të ndjekur nga afër gjithë procesin?

Zonja – Nuk kam lajmëruar asnjëri...Nuk mu duk, se kishte edhe aparat fotografik... Kamera jo e jo!

Burri me kostum – Ka edhe videoregjistratorë të fshehtë, që mund të vendosen kudo, edhe në një kopsë,karficë,apo orë dore...

Burri me karrocë – Unë propozoj t’i bëjmë vajzës një kontroll të imtë në çdo gjë!...

Gruaja – Rri,or plakush aty!Dashke edhe kontroll të imtë ti!Mos do edhe ta vemë në prehër në Jaguarin tënd?!

Burri me karrocë – (*përmallohet,po përpiqet të mos e japë veten*)Ah,sikur të ishte dikush tjetër në vendin e saj,që të më ulej në prehër!...

Gruaja – Ç’pate,plakush?T’u çua zemra peshë?Sa kohë ke pa e ke takuar?

Burri me karrocë – Shtatëmbëdhjetë vjet!

Gruaja – Gjatë të paska shkuar!Ja,pra,që edhe i egri,i serti,zemërguri e paska një pikë të dobët!

Burri me borsalinë – E cili nuk e ka një pikë të dobët?..*(vajza del nga tualeti)*

Vajza – (*zonjës*) Më falni,ju jeni e zonja e shtëpisë?*(ajo miraton me kokë)*Mbase këtu ka një keqkuptim! Unë nuk po shoh asnjë gjë që të më mbushë mendjen,se këtu po zhvillohet një...

Burri me karrocë – Çfarë prisni të zhvillohen?Lojra olimpike?

Vajza – Jo lojra olimpike,zotëri i mirë, po diçka aty afër...

Burri me mjekërr – Hë,pra nxirre!

Vajza – (*zonjës*) A keni dërguar ftesa ju?

Zonja – Po,kam dërguar..

Vajza – Po ku janë?

Zonja – Ja ku janë!

Vajza – Këta këtu?!

Zonja – Këta këtu!

Vajza – Po unë s'njoh njeri!...

Burri me mjekërr – Do njihemi,mos u mërzit,bukuroshe!As unë nuk njihja njeri prej tyre,kur erdha qëparë,tani i kam miqtë më të shtrenjtë, se jo vetëm që kemi lindur në një ditë,po edhe...Prit!Sot e ke ditëlindjen?

Vajza – Jo...Po kam ardhur për të festuar një ditëlindje...

Burri me mjekërr – Po ja, pra,në rregull je...Ne kemi ditëlindjen, ti ke ardhur për festë...

Vajza – Më falni,ju mos u tallni!Këtu duhej të ishte duke u tundur pallati nga të kërcyerit! Tani,jo se ka ndonjë e keqe,po...,si të them,gjithë kohën me ju do të kërcëj?

Burri me karrocë – Edhe me mua!Valsin e parë do ta kërcëjmë bashkë!..

Vajza – Jo,gjysh, me ju do të kërcëj,kur të jetë ndonjë heavy metal!...Po ku është, Xhesi, që ka ditëlindjen?Ku është Dj?Ku është Andi,i dashuri im?

Zonja – Vajzë e mbarë,ju paskeni hyrë gabim,vërtetë!Keni ngatërruar kat!Një kat më lart po zhvillohet një party të rinjsh...

Vajza – (*merr frymë e lehtësuar*)Të më falni!Me sa duket,kam ngatrruar kat,kam shtypur gabim butonin e ashensorit!...Që kur hyra,diçka kuptova,po thashë, se mos ishit të afërm, apo...nejse! Natën e mirë!...

Burri me mjekërr – Fati të ka lidhur me ne,jo me katin sipër!

Vajza – Ndoshta,njëherë tjetër,zotëri!Sonte më presin miqtë e mi!

Zonja – Për fat të keq,vajzë e mirë,ju nuk mund të shkoni askundi!

Vajza – Si nuk mund të shkoj?Çfarë doni të thoni?

Zonja – Se dera është e mbyllur!

Vajza – (*disi e irrituar*)Dera kur mbyllet,edhe hapet ashtu si mbyllet...

Zonja – Po,keni të drejtë,por jo sonte...Nesër!...

Vajza – Ju s'mund të më pengoni,zonjë,unë dua të ik tani, jo nesër?

Zonja - Nuk është e mundur, shpirt!...Djali që u hapi derën, u largua duke mbyllur derën nga jashtë...Ne nuk kemi çelës tjetër...Ai vjen vetëm nesër në mëngjes...

Vajza – (*gati në lot*)Po si mund të dal unë nesër,kur vetëm një kat më lart më pret festa,muzika,i dashuri...(kujtohet)Po mund ta marrim në telefon atë djaloshin e t'i themi të vijë tani!

Zonja – Nuk kemi telefon!...

Vajza – Ju lutem,zotërinj,a ka ndonjeri prej jush të më japë hua një celular?Do t'ia paguaj telefonatën!

Zonja – S'është fjala për të paguar!Asnjeri prej tyre nuk ka celularë!I kanë dorëzuar ashtu si edhe ti,kur hyre...

Vajza – Asgjë s'po kuptoj!Ç'është ky konspiracion!Ku gjindem,kështu?Ç'njerëz jeni?Pse ju kanë kyçur?Pse ju kanë mbledhur celularët?

Gruaja – Qetësohu,bijë!Nuk mund ta kuptosh kaq shpejt! As ne nuk do të donim të ishte një i huaj në mesin tonë...

Burri me karrocë – Se na humbet privacia...

Burri me borsalinë – Se edhe ne nuk do të donim t'i ndanim këto çaste me një njeri tjetër...

Burri me kostum – Se në këtë mes ka një të vërtetë, që ne do ta marrim me vehte për atje ku jemi nisur, për të mos u kthyer më...

Vajza – Unë asgjë,s'po kuptoj!Ju lutem më sqaroni...Unë dua të di,ç'po ndodh...

Zonja – Shpejt do të mësosh gjithçka...Po meqë fati të bashkoi me ne,qoftë edhe vetëm për sonte,pas pak ne do te hamë darkë...(të gjithë shohin njëri tjetrin)Po deshe, eja më ndihmo pak në kuzhinë...

Gruaja – Do që të vij edhe unë?

Burri me borsalinë – Jo,ti mos shko!

Burri me mjekërr – Pse nuk rri dot pa të?

Burri me borsalinë – Dua të diskutoj diçka!

Burri me mjekërr – Jo,kujtova se mos në prag të vekjes po na lind diçka...

Burri me borsalinë – Zotëri!

Burri me mjekërr – Jo,or mik,thashë ashtu kot, vetëm ngaqë po vë re,se ka ca minuta,që gati po e ha me sy...(burri me borsalinë matet të thotë diçka, po ai e ndërpret) Po,s'të thashë ndonjë gjë të keqe,or mik,mos u sikletos! S'kemi ç'mbajmë më sekrete! Hapini letrat!Rrëfihuni para meje,si para një prifti,edhe pse nuk jam i krishterë...

Burri me borsalinë – Më keqkuptuat!Unë e kisha fjalën,se mbase është tamam koha që ne vetë të përcaktojmë mënyrën...

Burri me kostum – Ku e ke fjalën?

Burri me borsalinë – Po,ja pra,mirë se do të vdesim, po si do të vdesim?!

Burri me karrocë – Fare thjeshtë,harro të marrësh frymë dhe këmbët përpjetë!

Burri me mjekërr – Ju vetëm talleni, po mua më duket, se zotëria ka të drejtë!Ndoshta zonja e shtëpisë do të na e lerë neve në dorë të zgjedhim!

Burri me borsalinë -Unë për vete nuk do të pranoj të vetevritem me armë!

Burri me mjekërr – Edhe unë e kam frikë gjakun!

Burri me karrocë – Të zë?Aq më mirë shkon atje i trullosur!

Burri me mjekërr – Unë ta di se hidhem nga dritarja e nuk pranoj të shoh tytën e një arme!Më kall krupën!

Gruaja – Nga dritarja nuk hidhesh dot!E kanë mbyllur hermetikisht!

Burri me kostum – Thyhet xhami!Hedhja nga dritarja është epike!.

Burri me karrocë – Varet se mbi kokën e kujt bie!

Burri me borsalinë – Është e tmerrëshme të mendosh se si plandosesh në trotuar!

Gruaja – Le,pastaj, që edhe tmerron njerëzit!

Burri me karrocë – Atë do të doja!Kjo edhe do të ishte kënaqësia ime e fundit, të tmerroja njerëzit!Në punën time më ka takuar të shoh shpesh herë skena të tilla...E imagjinoj, se si bërtasin e çjerrin fytyrat,se si,gjasme,përpiqen të të ndihmojnë, po bëjnë më shumë rromujë sillu e pështillu!Firmën e vura!Më ndihmoni dot ta mbylli hesapin tim që tani? (*kujtohet.Burrit me mjekërr*)Racionin e darkës sime po ta lë ty!

Burri me kostum – Sikur the, që do të sqaroheshim!

Burri me karrocë – Të pres atje!Zë një shtrat marinari!Ti lart,unë poshtë! Ou,Harrova! Mund të flë edhe unë lart!Atje do të kem edhe këmbë!S’do të jem plak!Po karrocën,kujt t’ia lë?E dini, se kam paguar goxha para?Në fakt unë e dija,se ma kishte dhuruar një shoqatë, po njëri,që dikur më thërriste “baba”,apo më saktë,një shoku i tij(*tregon burrin me kostum*),më kërkoi para.Më tha, se e kishte blerë!Mirë bëri!Tek e fundit njeri është! (*burrit me borsalinë*) Eja me mua,mik,lëri këta!Ke dështuar tërë jetën! Të paktën një herë në jetë,qoftë edhe për disa çaste fluturo,bëhu zot!Eja hidhemi bashkë!

Burri me borsalinë – Preferoj të shkoj i ngopur!Po pres darkën!

Burri me mjekërr – Unë sikur s’po kam shumë oreks!

Gruaja – E mbushe barkun me pije,sidomos me këtë këtu...(për *cocktailin*)

Burri me kostum – Apo ke frikë nga darka!...

Burri me mjekërr – Frikë?E pse të kem frikë?Qeni qepë të hajë!Ne e vendosëm..

Burri me kostum – Po,por ende jemi gjallë e pa helm në bark!Mendo edhe një herë!...

Burri me mjekërr – Kam vënë firmën!Pastaj,ku të shkoj? S’kam ku të djallosem! Veç në se e vini dorën në zemër ju,e...

Burri me kostum – Çfarë,do të ndroje mendim, po të jepja paratë?!

Burri me mjekërr – Jo se, kam ndonjë qejf të madh, po të paktën,nuk do të lija borxhe pas...

Burri me kostum – Ta mendoj njëherë!...

Burri me mjekërr – Mendoje një herë deri para darkës!

Burri me borsalinë – Pse,aty mendon ti, do të jetë helmi?

Burri me mjekërr – Aty,ku tjetër!

Burri me borsalinë – Po,shumë mirë,atëherë!Helm!Ta vendosim me helm!Ha ushqimin,nuk e di as se në ç’pjetë gjelle është, as nuk ndjen gjë! Ha, pi...

Burri me karrocë – Veç kur të nis barku e të del shkumë nga goja!

Burri me borsalinë – Pse,vërtetë ndjen dhembje barku?

Burri me karrocë – Pse, si e dashke,zotrote?!As armë,as gjak,as hedhje nga dritarja,as dhembje barku?

Burri me borsalinë – Jo,jo,s'po them gjë unë...Thjeshtë po pyes!Tani pak rëndësi ka!

Zonja – (*që ka dalë nga njëra nga portat*)Mos u mërzisni!Ja edhe pak!

Burri me mjekërr – Pse, mos po na ngut njeri?Ka kohë!(*burrit me kostum*)Po mendon?

Burri me kostum – Po mendoj...

Burri me mjekërr – Hë,u kthjellove ndonjë çikë?

Burri me kostum – Po përpiqem...

Burri me mjekërr – Përpiqu,përpiqu!...

Gruaja – (*burrit me mjekërr*) Vërtetë pret të t'i japë paratë?

Burri me mjekërr – Ku i dihet!Në çaste të veçanta ka njerëz, që e vënë dorën në zemër!

Gruaja – E di, atë shprehjen,që përfundon me... “të shohësh Stambollin?”

Burri me mjekërr – Jo,nuk e di!..

Gruaja – E, po,mësoje njëherë atë!Ka po atë kuptim, si ajo shprehja tjetër me “gomar” dhe me “bar”... Nuk të jep as një grosh, se ai paranë ka patur zotin e tij të plotfuqishëm!

Burri me kostum – Më njihkeni mirë!...Po unë s'mbaj mend të kem fjetur ndonjëherë me ju!..Dhe në përgjithësi, nuk i kam preferuar prostitutat...

Burri me borsalinë – Zotëri,nuk bëni mirë që fyeni një grua!Sonte këtu jemi të gjithë të barabartë!...

Burri me kostum – Kur përmendët profesionet,sikur nuk dëgjova, që të keni punuar ndonjëherë si avokat!...Apo,gabohem?

Burri me borsalinë – Jo,nuk gaboheni!Veç sonte sikur nuk shkojnë sherret e zënkat!

Burri me mjekërr – Aty është banjoja?

Zonja – Aty! (*ai largohet*)

Gruaja – Unë po shkoj t'i ndihmoj vajzës! E shkreta!Vajti e ra në gropë të grerëzave!

Burri me borsalinë – Të vij edhe unë?

Gruaja – Ç'më ngjitesh si pullë?

Burri me borsalinë – Si të duash!...

Gruaja – Mirë,eja!...

Zonja – (*i afrohet burrit me karrocë*)Vërtetë nuk keni asnjë peng nga kjo jetë?

Burri me karrocë – As edhe një të vetëm!...

Zonja – Mua nuk më rezulton kështu!

Burri me karrocë – Paskeni gërmuar në arshiva?

Zonja – Sigurisht! Nuk doja t'ia lija gjithëçka rastësisë...Sidomos me ju të dy... Meqenëse fati ju kishte lidhur kohë më parë...

Burri me kostum – Shumë kohë më parë!...Shtatëmbëdhjetë vjet më parë!...

Zonja – Dëshëroni ta hapim këtë temë?

Burri me karrocë – Mbase erdhi çasti...Nuk është mirë të shkojmë andej të idhnuar!... Më mirë pajtohemi!...

Zonja – Po ngjarja ka lidhje edhe me një person të tretë...

Burri me karrocë – Mirë e quajtet, person të tretë..Vazhdoni ta quani kështu deri në fund...Person i tretë!

Burri me kostum – Ne ishim tre shokë...Po ai nuk mund të quhet person i tretë...Ai është djali juaj!

Burri me karrocë – Unë nuk kam djalë!...Ka shtatëmbëdhjetë vjet që nuk kam djalë!...

Burri me kostum – E humbët vetë me zemërgurësinë tuaj...

Burri me karrocë – E humba, kur u përpoqa ta fitoj...

Burri me kostum – Duke e rrasur brenda?

Burri me karrocë – Duke e ruajtur që të mos zhytej më thellë...

Burri me kostum – Prap atë mendim ke?

Burri me karrocë – Prap do të bëja të njëjtën gjë, sepse kështu jam gatuar...Njihja mirë ligjin dhe ligji thoshte qartë e prerë, se duhej dënuar ai dhe partneri i tij,...

Burri me kostum – Po ligji dënoi vetëm djalin tuaj...

Burri me karrocë – Gabuat!Jo ligji...Ligji duhej ta dënonte partnerin e tij dyfish...Në provat e mia të dërguara në gjykatë vertetohej katërcipërisht, se paratë e partnerit të tij binin erë...

Burri me kostum – Paraja nuk ka erë...

Burri me karrocë – Ka para që kutërbon, e qelbet një orë larg!...Nuk e ndjen këtë vetëm një që i ka hundët e zëna, apo që s'ia do qejfi e bën sikur s'e ndjen...Dhe

gjykata,që i kishte hundët e zëna nuk dënoi fajtorin e vërtetë...Çuditërisht u ç'blokuan hundët,kur erdhi puna për personin e tretë...

Zonja – Prap po e quani person i tretë?

Burri me karrocë – Nuk ka emër tjetër!Ka shtatëmbëdhjetë vjet që nuk e ka takuar më të atin...Edhe kur i ati mbeti vetëm,edhe kur u paralizua...Nuk e mori qoftë edhe njëherë në telefon,të paktën për të marrë vesh në rronte,apo qe bërë darkë minjsh...

Zonja – Mëria ngandonjëherë sundon gjatë...

Burri me karrocë – Mëria ndaj atij që i bëri kokën?Ju të dy mendoni,se unë e kam patur të lehtë të dërgoja në gjykatë prova kundër tim biri? Po ç'farë të bëja,t'i fshihja? Apo ta mbyllja çështjen si të paqenë!Apo të gjeja ndonjë fakir, e t'i vishja fajin?Jo,këtë nuk do ta bëja kurrë...Se,kur fillova punë qeshë betuar në nderin tim! E nderi,siç edhe e thamë pak më parë,nuk është këmishë shtati,qe hiqet e vishet kur të duash!

Burri me kostum – Nderi,nderi,po,ama,dy vjet burg i hëngri yt bir!...

Burri me karrocë – Po...I hëngri...Po më mirë...Më mirë burgu, se të zhytej edhe me thellë në llumin e mikut të tij...Besoj e ke marrë vesh,se si ka përfunduar!

Burri me kostum – Diçka kam dëgjuar...Gazetat shkruanin, se ishte një aksident...

Burri me karrocë – Ashtu u tha e ashtu u shkrua, por nuhatja e një prokurori e gjykatësi profesionist mendon se, ishte një aksident jo aksidental... Dikush ka ndjekur pas ërën e parave të tij...

Burri me kostum – Pas asaj që ndodhi, ne u shpërndamë...Edhe me tënd bir, shumë rrallë jam takuar...Pasi kreu dënimin,siç e di,u largua nga qyteti...Vetëm ndonjëherë në telefon... Po ta kisha celularin, e sigurisht,po të kishe dëshirë,mund t'i thoje diçka...

Burri me karrocë – Tani është vonë...Do vijë koha që ai ta kuptojë...

Burri me kostum – Ke vuajtur këto vite?Nuk të është gjetur njeri pranë?

Burri me karrocë – E ç'rëndësi ka?Nuk i jam qarë kujt!Nuk dua t'i dhimsem dynjasë... Nuk më pëlqen mëshira...E kam urryer gjithmonë...Përherë i kam patur zët ata të pandehur,që kërkonin mëshirë në çastin e fundit:"Kërkoj mëshirë nga trupi gjykues!" Prandaj dua të ik që këtej një sahat e mëparë...Unë ka vite që jam i vdekur...

Zonja – Vërtetë nuk keni asnjë peng?

Burri me karrocë – E kisha dhe e kam një peng...Një shpresë...Një dëshirë të vetme... Ma mbyti ai personi i tretë,që ju të dy u përpoqët të më mbushnit mendjen,se na qenka im bir!...

Zonja – A mund të na e thuash!S'keni pse e mbani më brënda!

Burri me karrocë – E ç'rëndësi ka?Është vonë!

Zonja – Të paktën,lehtësohesh...

Burri me karrocë – Çuditem si nuk kam plasë me kohë...Të gjithë thonë se jam njeri i hekurt,po edhe njeriu i hekurt e ka një dobësi,siç u tha pak më parë...Kam një dashuri të pakufishme,të pamatë,të papërshtueshme...Vërtetë e kam ndjerë mungesën e tim biri...Po më ka përvëlur mungesa e mbesës sime... Shtatëmbëdhjetë vjet që nuk e kam parë,qysh pas gjyqit...Atëherë ishte tre vjeç...Tani do të jetë bërë goxha vajzë, e mbase edhe grua...Nuk e kam parë,as përkëdhelur,as puthur,sepse ai,për të cilin ju më thatë, se qenka im bir,ma mohoi,ma fshehu,ma largoi qëllimisht për t'u hakmarrë ndaj meje me dënimin më mizor...Një gjë të tillë e bën vetëm njeriu!...

Gruaja – *(del nga dhoma)*Tavolina është gati!

Zonja – Ju lumshin duart!Po presim edhe pak,që t'i hamë gjellët e ngrohta...

Burri me borsalinë – *(del dhe i afrohet dritares)*Më duket, se u lodh stuhia!Ka filluar të paqëtohet...

Burri me mjekërr – *(duke dalë nga banjoja)*Keni parë ju, se në banjo shpesh të vijnë mendime interesante?

Zonja – Përshembull?

Burri me mjekërr – E kisha me zotërinë*(për burrin me kostum)*...Po mendoja,po sikur të vepronim kështu?Ju më jipni paratë,sa për të larë borxhet,edhe unë ua shlyej pastaj duke punuar për ju pa pagesë...

Burri me kostum – Ti thua të hapim një biznes të ri në botën tjetër?Pse edhe atje do të punojmë?!

Burri me mjekërr – Jo,në këtë botën këndeji!..Nuk ka marrë fund ende...I kërkojmë falje zonzës për mundimin e shpenzimet dhe krisim e ikim...

Burri me borsalinë – Ku të ikësh?Dera është e kyçur deri në mëngjes...

Burri me mjekërr – Ikim nesër në mëngjes,me të ardhë djaloshi...

Zonja – Kemi kohë për të menduar për këtë,me gjithëse nuk ia vlen...

Burri me mjekërr – Pse nuk ia vlen?Njeriu duhet të përpiqet deri në fund të dalë nga situata ...*(për burrin me kostum)*Ja që ka edhe njerëz të mirë në këtë dynja!...

Burri me kostum – E di se kam filluar të lëkundem?Mund ta shikojmë atë idenë tënde që të lindi në banjo!...Pse të mos bëjmë mirë në këtë dynja?!

Burri me karrocë – Të hamë darkën njëherë...

Burri me mjekërr – Unë sikur s'po kam shumë oreks!.. *(burrit me kostum)*Edhe ju bëni mirë të mos hani!...Sikur ndihet lehtë njeriu, kur nuk ha darkë!...

Burri me kostum – Pse,zonjë, aty e keni hedhur helmin?Po në cilën nga gjellët?

Zonja – Kjo është darka jonë e fundit dhe e mira do të ishte të uleshim në tryezë të gjithë...

Burri me karrocë – Edhe vajza?

Zonja – Edhe vajza!

Burri me karrocë – Jo këtë nuk do ta lejoj kurrë!

Zonja – Sepse të kujton dikë, apo jo?E pyeta qëparë dhe më tha se ishte vetëm njëzet vjeçe...Edhe ajo që keni ju në mendje kaq do të jetë...Shtatëmbëdhjetë vjet pa e parë plus tre,plot njëzet!... Moshatare!...

Gruaja – Ju nuk mund ta bëni këtë! Ajo s'ka lidhje me ne!..

Burri me mjekërr – Askush nuk mund të më detyrojë të ha,kur nuk dua!...

Zonja – Mund të mos hani,zotëri!Mua do të më vijë keq,vetëm se do të humbisni rastin të provoni dorën time si kuzhinierë..Jam përpjekur të zgjedh gjellë të veçanta e tradicionale, që sigurisht,nuk keni për t'i provuar kurrë më...

Burri me mjekërr – Ku i dihet!

Zonja – I dihet,zotëri,si nuk i dihet!A keni dëgjuar, se ne mes të dy botëve ka edhe një të ndërmjetme? Kjo do të thotë, se nuk je as andej e as këndej?

Burri me borsalinë – Doni të thoni, se ne jemi pikërisht në këtë botë të ndërmjetme?

Zonja – Pikërisht,zotëri!

Burri me borsalinë – Gjë që nënkupton, se helmi nuk gjendet në asnjërën nga pjatat e darkës!

Zonja – Krejt i saktë,zotëri!

Burri me mjekërr – Ky është mashtrim!Ju doni të na bindni të hamë darkën tuaj!Mua nuk ma hidhni dot!..

Zonja – Zotëri, as që kam dyshimin më të vogël në inteligjencën tuaj,po unë po ju them të vërtetën!Dhe s'ka si të ndodhë ndryshe,kur vetëm pas pak të gjithë ne,pa përjashtim, do të dalim para gjykimit të zotit...

Gruaja – Gjë që do të thotë,se e kemi marrë rrugën...

Zonja – Po,me dëshirën dhe vullnetin e lirë të gjithësejçilit...

Burri me borsalinë – Pra,helmin e kemi në gjak dhe ai ka filluar të veprojë...(zonja tund kokën në shenjë miratimi)(gruas)A nuk të thashë?(zonjës)Mos ishte gjë në atë dollinë me cocktail me arrë kokosi,pjepër,shegë dhe rum,një pije tradicionale e familjes?

Zonja – Aty ishte zotëri!(pauzë.Burri me mjekërr shembet në kolltuk)

Burri me kostum – Më vjen keq,or mik!Unë sapo do të vendosja t'i përgjigjesha pozitivisht propozimit tuaj!...

Gruaja – Dhe kam frikë,se do të jesh i pari...

Burri me mjekërr – I pari,për çfarë?

Gruaja – I pari për atje!

Burri me mjekërr – Pse unë i pari?

Gruaja – Sepse,sikur e pëlqeve pak si shumë atë cocktailin dhe pive pak si tepër!...

Burri me karrocë – (*me inat*)Madje qerase edhe vajzën, pa të thënë kush!

Zonja – Mos!

Burri me karrocë – Po tani?!

Zonja – Nuk zhbëhet!...Fati i saj!Kështu paska qenë shkruar!Erdhi papritur e kujtuar, ngatërroi portën,piu atë që s'duhej të pinte!...

Burri me borsalinë – Ta detyrojmë të vjellë!

Burri me mjekërr – Pse, a ka shpresë?

Zonja – Asnjë shpresë!Helmi është tepër i fortë...Tani ai po bën punën e tij në gjak...

Burri me kostum – Vajzës nuk duhet ti themi asnjë fjalë!Të paktën të mos e përjetojë deri në fund!

Gruaja – E shkreta vajzë!Vetëm njëzet vjeçe!

Burri me karrocë – Eh!(*fshin sytë*)

Zonja – Ky është fati!Ngandonjëherë bashkë me kamikazët,shkojnë edhe shumë të pafajshëm, madje edhe miq të tyre,kur nuk lajmërohen në kohë!...

Burri me kostum – Edhe sa na mbetet?

Zonja – Rreth dy orë!Mos u merakosni!Nuk do të ndjeni asgjë!...

Vajza – (*del nga kuzhina*)Gjithëçka gati,zonjë!

Zonja – Urdhëroni të hamë një kafshatë nga darka jonë e fundit!

(*ngrihen të gjithë si qejfprishur dhe futen.Disi prapa ka mbetur burri me karrocë.Vajza i afrohet*)

Vajza – A mund t'ju ndihmoj,zotëri?

Burri me karrocë – Të faleminderit!Po se patët problem, do të kisha një dëshirë!

Vajza – Urdhëroni flisni!

Burri me karrocë – Pak më parë ju më quajtët gjysh!Unë kam një mbesë në moshën tënde,që e dua shumë,të cilën nuk e kam parë prej kohësh!A ka mundësi të më thërrisni “gjysh” deri sa të jemi këtu?

Vajza – Pse jo?Edhe unë kam një gjysh,që ngordh pas tij..Ai bën edhe më shumë pas meje...Jeton krejt ngjitur me ne..Unë më shumë rri andej, se në shtëpinë tonë...

(Dritat.Muzikë)

Veprimi i tretë

E njëjta skenë.I njëjti sallon.Të gjithë janë ulur në vende të ndryshme.Vajza rri në këmbë pas burrit me karrocë.

Burri me borsalinë – Ju lumshin duart,zonjë!I kishit qarë gjellët...

Gruaja – Na u dukën aq të mira edhe për vetë rrethanat...Darka e fundit në këtë botë!

Vajza – Darka e fundit në këtë botë?Ç'doni të thoni me këtë?

Burri me borsalinë – E fundit,do të thotë që nuk ka tjetër...

Vajza - Qysh kur erdha këtu, jam ndjerë disi budallaqe,se s'po kuptoj asgjë, ku doni të dilni me atë të folmen tuaj, plot nënkuptime,kode, a thua se flisni për diçka imagjinare, sikur flisni për një botë jo reale, po të përtejme...

Burri me kostum – Keni të drejtë..Sa vjeç jeni?

Vajza – Njëzet.

Burri me kostum - Ju punoni apo jeni studente?

Vajza – Edhe punoj edhe studioj.Më pëlqen shumë të bëhem një art disigner..

Gruaja – Mos doni t'i kërkoni tani edhe ku banon edhe numrin e telefonit?

Burri me kostum – Pse,jo,nuk do të ishte keq!

Gruaja – Lëreni rehat vajzën!Ju deri tani keni njohur vetëm forcën e perëndisë tuaj, parasë...Me të jeni përpjekur të blini gjithçka!Gjithçka!Që nga mishi i kaprollit e deri tek i imi apo i shoqeve të mia!...Tani paratë nuk të pinë ujë më!...Më mirë lutuni për mëkatet tuaja,se ma do mendja,do ta kesh ndonjë!..

Burri me kostum – Me siguri,zonjë, do ta kem ndonjë...Po ju, a thua, do ta keni ndonjë? Nejsë,sonte kemi bërë pakt të mos grindemi, për kaq kohë, sa na ka mbetur...

(vajzës)Kur më ndërpreu zonja,desha t'ju pyesja: a keni menduar ndonjëherë për vdekjen?

Vajza – Si ju shkon mendja të më bëni një pyetje të tillë,zotëri?!Si mund të mendoj për vdekjen,kur unë sapo kam filluar jetën...Tek e fundit çdo njeri lind të ëndërrojë për jetën e jo për vdekjen...Unë punoj,studioj,dashuroj!Ç'dua më tepër se kaq?Në çdo hap ndjej gëzim,lumturi...

Gruaja – Po jeta nuk janë vetëm këto...

Vajza – E di,kam lexuar e dëgjuar...Ka edhe tatëpjeta...Edhe prindërit kështu më thonë shpesh! Po unë jetoj me të tashmen...Ajo është e bukur..Pse duhet ta vras mendjen,se çdo të ndodhë në të ardhmen?

Gruaja – Po, se në jetë njeriu mund të ketë edhe halle,telashe,brenga, shqetësime, peripeci...

Vajza – Po ato përse ekzistojnë,zonjë?A nuk ekzistojnë vetëm e vetëm që të kapërcehen?

Burri me borsalinë – Megjithatë vjen një çast, që njeriu thyhet...

Vajza – Thyhet njeriu i dobët, i forti jo...

Burri me borsalinë – Po njeriu nuk është hekur...

Vajza – As xhelatinë...

Buri me kostum – Ju pyeta, për vdekjen...

Vajza – Unë jam e re,zotëri, po me sa ma merr mendja mua,të vdesësh do të thotë të mos shohësh më Da Vinçin a Rembrandin,të mos dëgjosh Bethovenin a Moxartin,të mos zgjohesh në mëngjes nga cicërimat e zogjve,të mos shohësh një manushaqe që lind në një gëmushë,të mos dëgjosh fëshfërimën e gjethëve në pyll apo shushurimën magjepëse të ujëvarës,të mos vraposh pas flutrave të dëborës që bien, apo të mos të zhytesh në valët ledhatore të detit...Po të doni unë mund të rri gjithë natën, duke ju përmendur mrekullitë e kësaj bote,zotëri...

Burri me kostum – Nuk do të kemi kohë,zonjushë,nxitojmë...

Vajza – Për ku nxitoni? Pse nxitoni?Ju më thatë, se dera është e mbyllur, pra deri në mëngjes nuk kemi ku të shkojmë...

Burri me borsalinë – Ne do të shkojmë atje ku nuk kthehemi më...Në botën tjetër..

Vajza – Kush do të shkojë?Pse nuk flisni më troç, po e dridhni tërkuzë?

Gruaja - Ne të gjithë...Na ka ardhur në majë të hundës!

Vajza – Jeni lodhur nga jeta?Po një jetë e rënduar nga hallet mund të marrë kthesë, vetëm vdekja është e pakthyeshme!...Ju flisni për jetën e përtejme,pa përfunduar në

kohë këtë të përparmen...Është njëloj, si të thuash,një njeri i mbetur, pothuajse i ngrirë në dëborë, që vendos t'i dorëzohet ngricës, edhe pse kanë mbetur vetëm pak metra përpjetë,ku në shpatin tjetër mund të gjendet një shtëp, që ta strehojë e ta ngrohë...

Burri me kostum – Ne nuk duam të ngjitemi deri në majë të kodrës...Ia kemi pirë lëngun!..

Vajza – Me të vërtetë e ka,gjysh, apo tallet?(*burri me karrocë pohon me kokë*) Po ju jeni i vjetër,gjysh,keni parë e dëgjuar shumë,ndaloji këta njerëz,sa nuk është vonë,të mos e hedhin këtë hap të çmendur,(*burrit me kostum*)mos u tregoni egoist zotëri! Ç'është gjithë kjo mëri, që keni me njerëzimin,(*gruas*),ju,zonjë,që u sollët aq mirë me mua,që keni një zemër të dhembshur dhe jeni kaq e pashme (*të dyve*)edhe ju zotërinj të nderuar,të sjellshëm e xhentilë, gjeni një grimë dritë edhe në errësirën tuaj të plotë... Edhe ju zonjë, bëni diçka,për këta njerëz,sa nuk është vonë...

Zonja – Është vonë...Vendimi që kishin marrë njëzëri u ekzekutua...Ka mbetur edhe fare pak kohë...

Vajza – Po mbase janë penduar,bëni diçka,gjeni një mënyrë për të lajmëruar spitalin...

Zonja – Nuk ka asnjë mënyrë!...(shkon në kuzhinë)

Burri me mjekërr –(*deri atëherë nuk ka thënë asnjë fjalë*) Po të donte mund të gjente një mënyrë...Po nuk i intereson!

Burri me borsalinë – Pse,nuk i intereson?

Burri me mjekërr – (*i afrohet burrit me kostum*)Kam filluar të dyshoj!Të gjithëve na ka pyetur, pse kështu e pse ashtu,për vetën e saj s'na ka thënë asgjë fjalë...Këtu bie erë mish dhie!...

Burri me kostum – Ti shquhesh për nuhatje...Pse thua?

Burri me mjekër – Biznes!

Burri me kostum – Ou?!

Burri me mjekërr – Biznes organesh!...Qysh nesër fillojnë ofertat!Unë nuk do të pranoja që trupi im të përfundonte për eksperimente shkencore...

Burri me kostum – E ke gabim!Mund të jetë biznes i mirë për të lehtësuar borxhet...

Burri me mjekërr – Nuk i imagjinoj dot veshkat e mia në dorë të kasapit...

Burri me borsalinë – Punë e madhe fort!Pak rëndësi ka,se ç'bëhet me ta! Nëqoftëse i vlejné, dikujt le të marrë ç'të dojë!

Gruaja – E di se ku mund t'ju shkojë mendja juve,po disa nga organet e mia, mund të bënin goxha para!(*burrit me mjekërr*) Bëj kontratë me zonjën,shkruaj edhe në amanetet për djaloshin nesër,që unë t'i dhuroj ty..Me paratë e tyre mund të lash ndonjë borxh!

Burri me mjekërr – Ç'mi kujtove tani?

Burri me karrocë – Unë s'të ndihmoj dot!Të gjitha organet i kam në pension!...

Gruaja – Kanë dalë ca ilaçe tani, që...

Burri me karrocë – S'ka ilaç që m'i kthen në jetë!...

Burri me mjekërr – Kushedi sa do t' i bëhet qejfi komshijes përballë!Na e mori të keqen, do të thotë...E pastaj do të nisë të numërojë këtë e atë, sa për t'ia plasur zemrën time shoqeje...Edhe kunatës do t'i bëhet qejfi...

(drita lokalizojnë gruan dhe burrim me borsalinë)

Burri me borsalinë – Po më merret fryma!

Gruaja – Po ti hiqe kollaren!Edhe në varr do të shkosh me kollare?Nuk ke frikë se ta shtërngon fytin si lak?

Burri me borsalinë – Më ndihmon ta heq?(*ajo i afrohet dhe e ndihmon*)Të faleminderit! Je shumë e mirë! Sa keq që s'të kam njohur më parë!... Mund të kishte qenë krejt ndryshe jeta e të dyve ...

Gruaja – Të dukem pulë e jo sorrë,se janë rrethanat e veçanta!...

Burri me borsalinë – Po të ishte për rrethanat, nuk do më bëje përshtypje fare...

Gruaja – Atëherë,ndoshta ke shumë kohë që s'ke ndenjtur me një femër!...

Burri me borsalinë – Nga e di ti?

Gruaja – Ndjej një drithërimë brenda teje...

Burri me borsalinë – Ndoshta nuk do të ma besosh,po kur jam ndodhur pranë një gruaje,kurrë nuk kam patur këtë lloj ndjesie që kam tani...Se ç'kam një ngohtësi të përgjithëshme, a thua, se diçka më zjen përbrenda...

Gruaja – I shkreti ti!

Burri me borsalinë – Nuk tallem...Dhe nuk është thjeshtë, ashtu si e mendon ti...Është shumë më shumë se aq...As edhe sytë nuk më janë verbuar!...

Gruaja – Janë minutat që rrëshqasin dhe koha që shkurtohet...

Burri me borsalinë – Jo,më duket, se po provoj atë që nuk e kam provuar në dhjetra njohje e në dy martesë...Duket, se edhe ky është një tjetër trill i fatit,që kërkon të tallet deri në fund...

Gruaja – (*i kap dorën*)Ç'të bësh!Nuk e ndryshojmë dot!

Burri me borsalinë – Po të ishte ndryshe,unë nuk do t'i sajoja vetes njëqind e një arsye, për të shtyrë kohën rrugëve, po drejt e në shtëpi...

Gruaja – Dhe unë do të prisja shend e verë tek shkallët...

Burri me borsalinë – Dhe shtëpia do të kishte dritë...,nuk do të ishte e errët,për të më ngrënë me boshin e saj...apo për të më cingrisur nervat me atë pusullë të akullt mbi tavolinë,që më bënte të ditur,se zonjës i kishte dalë një punë e ngutëshme, dhe se ajo, madje, më kërkonte ndjesë,po të vonohej ca edhe në darkë...

Gruaja – Do të uleshim bashkë në tryezë...

Burri me borsalinë – Bashkë...

Gruaja – Me pjatën e ngrohtë përpara,me një gjellë, që unë do të kisha sajuar vetëm për ty...

Burri me borsalinë – Që, sigurisht,që nuk do të ishte vezë të fërguara,apo diçka e tillë,që kur i përmend më japin alergji...

Gruaja – Jo,shpirt,vetëm gjellë të larmishme e të shijëshme!

Burri me borsalinë – Sa qejf!Do të pinim dhe një gotë verë e do të flisnim pa thumba e kunja me njeri tjetrin...

Gruaja – Ç'e do!Është vetëm një ëndërr me sy hapur!..

Burri me borsalinë – ... që presin të mbyllen për të mos u hapur!...

Gruaja – Le t'i tregojmë bryllin fatit!

Burri me borsalinë – Ç'të bëjmë?

Gruaja – Asnjë minutë të humbur!A nuk është më e mirë mjalta, se qepa?Le të bëjmë qejf!

Burri me borsalinë – Qejf?!

Gruaja – Dua të bëj njëherë qejf,për qejf!Jetuam fatkeqë,le të vdesim të lumtur!(*e kap për dore dhe e tërheq drejt njërës nga portat.*)

Burri me mjekërr – Ky është kulmi!Nuk kanë thënë kot,fshati digjet e..ajo ..krihet!

Burri me kostum – Një çift ideal!..Double P!Politikani dhe ...

Burri me mjekërr – Prostituta!

Vajza – Mos flisni për ta,zoteri! Ata mirë e kanë!

Burri me mjekërr – Si e kanë mirë?Në vend që të vrasim mendjen, si të gjejmë një rrugë për të shpëtuar,na mbyllen edhe në dhomë!...Gili gili,kështu,gili gili ashtu!

Vajza – Asnjë sekondë e jetës nuk duhet çuar dëm!

Burri me mjekërr – Po,po,fol fol,ti,po të shohim edhe ty pas pak, se si do të kakarisësh!

Burri me karrocë –(*kërcënues*)Zotëri!Rrudh gjuhën!

Burri me mjekërr – (*bën me shenjë,që e kuptoi gabimin*)(*burrit me kostum*)Si thua,në se,do zoti e shpëtojmë,a do më mbash pranë?

Burri me kostum - As mos e vë në dyshim!

(*burri me karrocë kollitet.Vajza vrapon*)

Vajza – Gjysh,do pak ujë?(*ai pohon.Ajo shkon me vrap.Vjen zonja.Vjen vajza.Burri me karrocë e falenderon*)

Burri me karrocë – Rrofsh, moj bijë e gjyshit!

Burri me mjekërr – (*Zonjës*)Ne të gjithë folëm për motivet tona!Ju s'na thatë asgjë...

Zonja – Keni të drejtë...Po unë nuk kisha ndonjë motiv të fortë...Thjeshtë jam e lodhur...Si të them ...nga rutina e përditëshme...Ta zëmë,pas një nate të pa gjumë nga stresi,ngrihesh në mëngjes dhe sheh një mal me enë që duhet larë,pastaj shtëpia që duhet ndrequr...Vrapon sa të merret fryma për në punë, por të vonon autobusi... Bosi të hakërrrehet e të paralajmëron...Mezi mbaron orarin e vrapon për në shtëpi,po pa futur këmbët brënda në oborr gjen tèt shoq tapë, që edhe të shan e të fyen...Buka të zihet në fyt..Thua,po shtrihem pak të mbledh mendjen...Po nuk të lë telefoni...Është mësuesja e djalit tënd adoleshent ,e cila kërkon takim urgjent,se ai ka bërë një proçkë në shkollë e mund të jetë me zarar...Do më?Ditë për ditë e orë e çast!Deri sa të vjen në majë të hundës e thua:Në djall,gjthçka!

Vajza – Më falni,zonjë,ju gjithashtu po tregoheni egoiste!Të lodheni nga këto vogëlsira?! Po si ja bëjnë ata që s'kanë ç'të hanë,s'kanë ku të flenë, s'dinë në do t'u shembet çatia, ku kanë strukur kokat?E megjithate, prap se prap, gjejnë forcë të jetojnë... Këto që ju më thoni,e kanë një zgjidhje!...Ju vetëm u janë errur sytë nga stresi!...Të gjithëve u janë errur sytë nga stresi!Ju duhet të bëni çmosin të shpëtoni veten dhe të tjerët!Gjithë këta burra,mund ta shkallmonin derën!

Burri me mjekërr – Ide e mirë!(*shkon tek dera*)

Zonja – Është e pamundur!Dera është e blinduar!

Burri me mjekërr – Të provojmë të gjithë sëbashku!Thirrini dhe ata të dy!

Burri me kostum – Tani nuk është momenti i duhur për t'u hyrë në dhomë...Mund të kenë kapërcyer shumë etapa!...

Burri me mjekërr – Ejani ju,të paktën!..Mund të bëjmë ca zhurmë me derën e mund të na dëgjojnë kalimtarët...(*fillon t'i bjerë derës me forcë*)

Burri me karrocë – Mjaft na çave kokën!Na ler të mbyllim sy të qetë!

Burri me mjekërr – Ti mund të bësh ç'të duash!Ke lindur vetëm, vetëm ik!Unë jam bërë pishman si dreqi!E ma do mendja edhe ata të dy në dhomën e gjumit!...(*shkon tek dritarja.Dëgjojen këmbanat*)Ja i dëgjoni?Po bien këmbanat...Sonte shugurohen pesë,

jo... gjashtë(*sheh nga vajza*) apo shtatë shenjtër të rinj!Madje midis tyre edhe unë që nuk jam i krishterë...

Burri me kostum – S'ka gjë! Në atë botë të gjithë janë njësoj,të krishterë,muhamedanë, protestanë, indu... As parti!..As grup parlamentar!...Atje ndahemi vetëm të dliurë e mëkatarë ...Madje bëjmë mirë të rrëfëhemi!

Burri me mjekërr – Ku do ta gjeni priftin?

Burri me kostum – (*vajzës*)Ndër ne, ti duhet të jesh më pak mëkatarja! Prano të dëgjosh mëkatet tona!...

Zonja – Po, ajo është më e pastra ndër ne!Po më parë desha t'ju pyesja për diçka!

Burri me mjekërr – Urdhëro!

Zonja – Jo,nuk e kisha me ju!...Në këtë pikë,ju sigurisht,mbeteni jashtë...E kisha me ju të dy, zotëri...

Burri me karrocë – Ç'pikë e planit ka mbetur pa realizuar?!

Zonja – Testamenti!Ka mbetur edhe fare pak kohë,për t'ë lënë ndonjë amanet,në se nuk është përfunduar me kohë...

Burri me karrocë – Me moshën dhe profesionin tim,do të ishte gjëja e parë që do të më vinte në mendje...

Burri me kostum – Unë as që e kam vlarë mendjen! Sytë i nxjerrshin njeri tjetrit ortakët, sekretarët,kushërinjtë!...Pre çakejsh u bëfshin për njeri tjetrin!Nuk dua t'ia di, se si do t'i ndërsulen njeri tjetrit,për të shqyer llokmat e majme...

Vajza – Më falni,zotëri,po si mund të flisni kështu,kaq pa dhembje për pasurinë tuaj,që e keni vënë me mund e djersë?Si mundeni,që t'ua lini kaq me indiferencë e pa të therur në shpirt të pamunduarve, që,tek e fundit, do të fërkojnë e ngrohini duart si mbi gështenja të pjekura? E ndërsa do të rrëmbejnë llokmat, që ju thatë,do të çmenden nga gëzimi për këtë dhuratë të rënë qielli, kur nuk e prisnin.Madje edhe do të zgërdhieshin apo do të nënqeshin me ironi për aktin tuaj...

Burri me kostum – Ajo pasuri do t'u ngecë të gjithëve në fyt!

Vajza – Pse, edhe mund ta gëzojnë? Ju vetë ua dhuruat!Tek e fundit,i gjalli me të gjallët!...

Burri me karrocë – Po,ama, ne te vdekurit do të shetisim nepër kopshtet e Edenit,në parajsë...

Vajza – Nuk është keq të ëndërrosh edhe për to,po unë tani për tani më mirë preferoj të kënaqem me aromën e luleve të gjalla në parkun përballë...

Burri me karrocë – Jeni shume e zgjuar,bijë!

Zonja – Edhe pse është vetëm njëzet vjeç!

Burri me karrocë – Ma thatë njëherë zonjë! Për fat të keq,kam kujtesë të mirë!
(*largohet paksa mënjanë me karrocë.*)

Vajza – Pse u mërzite,gjysh?(*i vë forën mbi flokë.Ai i kap dorën*)

Burri me mjekërr – (*burrit me kostum*)Të bëjmë diçka, sa nuk është vonë...

Burri me kostum – Ka përfunduar kjo punë!...Me sa duket ka nisur efekti!...

Burri me mjekërr – Vërtetë thua?Prandaj unë kam nisur të ndjej një therje të lehtë,ja këtu!(*tregon me gisht*)

Burri me kostum – Po mentë,të merren?

Burri me mjekërr – Prit,sikur po më mirren pak!

Burri me kostum – E shikon?S'na mbetet gjë tjetër tani,veç ta presim të qetë e gjakftohëtë fatin tonë!...

Burri me mjekërr – (*zonjës*)Kjo nuk është e drejtë!Njeriu edhe pendohet!

Zonja – Ashtu është, po unë nuk ju detyrova!

Burri me mjekërr – Ju duhej të kishit një variant rezervë,për një rast si ky!

Zonja – Mundet, po nuk më kishte shkuar ndërmend!...

Burri me kostum –Kam dëgjuar, se ka njerëz që u hapin varret të...ndjerëve...

Burri me mjekërr – Edhe unë...Të paktën të mos na përdhosnin...varrin!

Burri me kostum – Kam frikë,se tëndin po...

Burri me mjekërr – Timin?Pse?

Burri me kostum – Ke dhëmbë floriri..I është rritur shumë vlera floririt!

Burri me mjekërr – E ke me gjithë mend?Po ku do ta marrin vesh?

Burri me kostum – Ndonjeri prej borxhlinjve mund t'i ketë pikasur!Pastaj,të duket çudi, që të jetë dikush nga të afërmit e tu,gruaja apo njeri nga djemtë,të cilëve ua nxive jetën?

(*burri me mjekërr shikon njëherë dhe i drejtohet një pasqyre te madhe diku në skenë. Pastaj shkon në tualet*)

Zonja – (*vajzës*)Të lutem,a mund të na bësh ndonjë kafe,apo mos doni çaj zotërinj?

Burri me kostum – Çaj!

Burri me karrocë – Një kafe të fortë, po të mos e ketë çupa problem!(*vajza largohet (zonjës) Ç'ke për të na thënë tani,meqë enkas e largove vajzën?*)

Zonja – Prap për testamentin!

Burri me karrocë – Të thashë që ia kam lënë!...

Zonja – Kujt ia ke lënë?Mbesës tënde njëzet vjeçe?

Burri me kostum – Po ju, pse e theksoni moshën e saj,xhanëm?Mos doni të thoni se...

Burri me karrocë – (*ngrihet paksa*) Çfarë?!

Zonja – Nuk do t'ju pëlqente, që ajo të ishte mbesa juaj?!

Burri me karrocë – Në keni patur ndonjëherë gjë të shtrenjtë në këtë botë, mos luani me mua!Ajo është aq e mirë dhe brishtë,sa unë me të vërtetë, pata ndonjë çast,që mendova, se mos...

Zonja – Çfarë, nuk keni dëshirë,që ajo të jetë mbesa juaj?A nuk thatë se nuk e keni parë për shtatëmbëdhjetë vjet dhe kjo ju ka përvëlur?

Burri me karrocë – Në këto çaste nuk do të kërkoja gjë tjetër, veç t'i përkëdhelja flokët e t'i puthja sytë, por,të lutem më thuaj që nuk është ajo, të përgjërohëm fort,më thuaj që nuk është ajo!...

Zonja – E çuditëshme!Edhe do,edhe s'do!

Burri me kostum – Ju, zonjë,vërtetë nuk e kuptoni?Po si të dojë të jetë ajo, kur ky njeri deri më sot ka jetuar vetëm me një shpresë?!Doni në këto çaste t'ia vrisni atë shpresë?! sulur për të kapur majat,shpesh nuk ua vija veshin atyre që ndodhnin përreth meje...Kjo natë e çuditëshme më mësoi shumë gjëra,edhe pse vonë...(burrit me karrocë) Të kërkoj ndjesë!Dhe nëse më ka therur ndonjëherë zemra fort, kjo po ndodh vetëm sonte!

Zonja – Filluat të pendoheni?

Burri me kostum – Nuk e kam për vete!Unë nuk kam ndonjë motiv për t'u penduar!

Zonja – Po atëherë?

Burri me kostum – E kam fjalën për vajzën!Ajo nuk duhej sakrifikuar...

Zonja – Ishte rastësi!Edhe mua vërtetë më ther në shpirt!

Burri me karrocë – (*burrit me kostum*)Sa kohë ke që,që nuk je takuar me shokun tënd?

Burri me kostum – Domethënë me tënd bir?

Burri me karrocë – Të lutem përgjigju!

Burri me kostum – Shumë vjet...Pse pyet?

Burri me karrocë – Nuk të pyes për atë, po për vajzën...Kur e pe për herë të fundit,a ishte rritur ndonjë çikë?

Burri me kostum – E ke fjalën,a ishte rritur,sa për ta mbajtur mend?Nuk di ç'të them! Kanë kaluar ato vite të moshës,tamam kur çupat marrin hov e ndryshojnë shumë...Po,ç'ke ti,e pyes unë me takt!...

Zonja – Pyeteni,pyeteni, ku i dihet,mbase mund të kemi ndonjë surprizë të re!

Burri me kostum – Prap surpriza?!Të çfarë lloji këtë herë?

Zonja – Se vajza,siç mund të jetë mbesa e zotërisë,mund të jetë fare mirë...edhe vajza yte!

Burri me kostum – Çfarë thatë?!

Zonja – Vajza yte!

Burri me kostum – Ju lutem,zonjë,kjo është shakaja më e pavend,që mund të jetë bërë ndonjë herë...

Zonja – Ashtu mendoni ju,zotëri!

Burri me kostum – Dhe ashtu është!Unë nuk jam martuar ndonjëherë,që të kem fëmijë...

Zonja – Ka fëmijë që lindin edhe pa qenë i martuar!

Burri me kostum – Kjo është e pamundur!

Zonja – Asgjë nuk është e pamundur!Mos do të thoni, që kurrë në jetën tuaj nuk keni fjetur me një grua?

Burri me kostum – Jo,nuk e them!... Nuk mbahen mend sa kanë qenë!

Zonja – Kështu pra,me njërën nga ata, që nuk mbahen mend sa kanë qenë,këtu e njëzet vjet më parë, ju nuk jeni treguar i kujdesshëm, keni gabuar... Pasoja,një vajzë e bukur dhe e mençur si kjo këtu!

Burri me kostum – Paske gërmuar shumë !...

Zonja – Sigurisht,shumë!Doja të përzgjidhja më tipikët ndër ju!

Burri me karrocë – Ju thoni, se ajo nuk është mbesa ime?

Zonja – Nuk e di,edhe mund të jetë...

Burri me kostum – Po ju njëkohësisht thoni,se ajo është bija ime!..

Zonja – Nuk them se është, po mund të jetë...(hyn vajza me filxhanë.Zonja del)

(Burri me karrocë surbon kafenë e servirur,kurse burri me kostum pi çajin,i kredhur ne mendime)

Burri me karrocë – E paske qarë kafenë,bijë e gjyshit!

Burri me kostum – Edhe çaji qenka shumë i mirë!

Burri me karrocë – Me sa duket,mamaja ju paska mësuar,apo jo?

Vajza – (*ne mes të të dyve*)Po,mamaja..Më ka mësuar të punoj që e vogël...Ka vuajtur shumë e gjora!

Burri me kostum – Pse ka vuajtur?

Vajza – Po, sigurisht që ka vuajtur e vetme...

Burri me karrocë – Pse, e vetme?

Vajza – Nuk e di... Ajo asnjëherë nuk më ka thënë, përse... Po të tjerët më kanë treguar se...

Të dy – Çfarë?

Vajza – Se kur unë isha e vogël,babai se ku kishte ikur ...

Burri me kostum – Larg?Në kurbet?Apo mos,ndoshta, kishte rënë gjë në burg...

Vajza – Unë nuk e di,nuk mbaj mend,isha shumë e vogël...

Burri me kostum – Sa,tre vjeç?

Vajza – Po ç'ju them unë zotëri,nuk më kujtohet...Më vonë ai u kthye...(burri me kostum merr frymë)

Burri me kostum – Pra u kthye, ai,babai i juaj!...

Vajza – Ashtu më thanë,që ishte babai im!

Burri me karrocë – Të thanë,apo ishte vërtetë babai i juaj?

Vajza – Unë nuk e mbaja mend,po ashtu e kam quajtur dhe vazhdoj ta quaj deri më sot! Ai më do shumë...

Burri me kostum – Po sigurisht që do t'ju dojë!Jeni kaq e mirë!Si të mos e dojë babai fëmijën e tij?

Burri me karrocë – Ju sikur thatë,se keni një gjysh, që e doni shumë!

Vajza – Po,dhe është aq i mrekullueshëm!

Burri me karrocë – (*shikon burrin me kostum*)Dhe ju rrini aty pjesën më të madhe të kohës, meqë i keni edhe pranë!

Vajza – Ç'memorje! kujtoni pikë për pikë fjalët e mia!

Burri me karrocë – Sigurisht!Dhe kjo do të thotë,se ju nuk jeni...

Vajza – Kush nuk jam?

Burri me kostum – Ajo, që ne të menduam se ishe!

Vajza – Pse, kush duhej të isha?

Burri me karrocë – Mbesa ime!

Burri me kostum – Vajza ime!

Vajza – Keni shumë të drejtë!...

Zonja – po mund të jetë edhe e vërtetë...

Burri me karrocë – Çfarë mund të jetë e vërtetë?

Zonja – Po, ja, pra, që ajo të jetë mbesa juaj, apo, mbase, vajza e juaj...

Burri me kostum – Çfarë, po luan kukamçefthi me ne?

Vajza – Unë nuk di ç'të them! Zonja, mbase edhe ka të drejtë...

Burri me kostum – Po luan kukamçefthi me ne? Si paska të drejtë? Pastaj, ne sikur thamë fjalë të mira për ty!...

Vajza – Ju faleminderit, zotëri, jeni shumë i sjellshëm, po kjo nuk e ndryshon situatën... Unë nuk desha t'ua tregoja, po biseda mori një kthesë të tillë... Dhe mua më vjen, vërtetë, shumë keq për ju, që do të... nuk më bën goja ta them... Dhe gati më vjen për të qarë!...

Burri me karrocë – Gjithësesi, edhe pse ti mbetesh një çupë e mirë, nuk mund të jesh mbesa ime!

Vajza – Edhe ashtu mund të jetë, zotëri i mirë, nuk di ç'të them...

Zonja – Po pse e përjashtoni mundësinë e kundërt?

Burri me karrocë – Se ajo e ka një gjysh!... Apo jo?

Vajza – Po, po ka një keqkuptim!... Ai është gjyshi nga mamaja... Ku i dihet, ju, mbase, fare mirë, mund të jeni gjyshi nga im atë!...

Burri me kostum – E po atëherë rrezohet varianti tjetër: Ju mund të keni dy gjyshër, po s'mund të keni dy baballarë?

Vajza – Keni të drejtë, s'mund të kem dy, vetëm një! Po ky mund të jeni ju!..

Burri me mjekërr – Po si mund të jem unë, kur ju vetë e pohuat, se e keni babain...

Vajza – Ashtu kam menduar... Po këto ditë mësova, se ai me të cilin jetoj, është njerku im!...

Burri me borsalinë – *(duke dalë nga dhoma i zënë përdore me gruan)* Ej, dëgjoni të gjithë! Duam t'u lajmërojmë, se ne të dy sapo morëm një vendim! Do të martohemi! Zoti

gjykatës,ju jeni më i vjetri këtu dhe njëkohësisht përfaqësues i ligjit,ju lutem na shpallni burrë e grua!

Gruaja – Zonjë!A mund të më huazoni,në se keni, një fustan të bardhë?Erdhi dita,që edhe unë të nusëroj!...Qoftë edhe për pak çaste!Për herë të parë po ndjej vërtetë diçka për dikë...Tani... se si po më vjen të iki!...Edhe s'kam frikë nga asgjë,edhe kam frikë nga gjithëçka!...

Zonja – Ejani,zonjë!(*futen në njërën nga dhomat*)

Burri me mjekërr – (*që ka dalë pak më parë nga banjoja*) Kanë luajtur mendsh!Minutat një nga një po sosen,këta na ftojnë për dasëm!...

Vajza – Mirë e kanë!Le t' i marrin çdo çast kësaj jete,sa nuk ka rënë gongu...

Burri me kostum – Gongu shënon një fund...

Burri me karrocë – Po edhe një fillim...Çdo fund shënon një fillim...

Vajza – E mira do të ishte që fundi të vinte natyrshëm!

Burri me karrocë – Fundi është fund,sido që të vijë...

Vajza – Jo,gjysh,në se çdonjeri prej jush,do të përpiqej edhe më shumë të zhदारariste nga sytë atë ngjyrë të zezë me të cilën është lyer gjithçka dhe u ka errur shikimin, edhe mund të ishte disi ndryshe...

Burri me mjekërr – Mjaft filozofuat!Mua më vjen për të vjellë!...

Vajza – (*i afrohet*) Edhe sikur jeni zverdhur në fytyrë...

Burri me mjekërr –(*vrapon tek pasqyra*) Bëni diçka!Mos më lini në baltë!...

Burri me karrocë – Mos u qaravit ashtu,se nuk je kalama! Dhe mos bërtit!Ajo që do të vijë pas pak, le të vijë në qetësi...

Burri me mjekërr – Flet kollaj ti!Po unë as një gjysëm shekulli s'e kapa...(vë dorën në *stomak*)

Burri me kostum – E ke, se të janë përzier pijet!...

Burri me mjekërr – Jo,qafsha të gjithë!...

Burri me karrocë – Nuk shkon kjo be!Nuk ke kë të qash tani!Dhe, me sa duket, as kush të të qaj...

(*nga dhoma dalin Zonja, Burri me borsalinë e Gruaja e veshur me një fustan të bardhë të zënë për krahu.*)

Burri me borsalinë – Zoti gjykatës!Keni mirësinë të na legalizoni martesën! Faktikisht ne para pak kohe u bëmë burrë dhe grua!

Burri me mjekërr – Ju rroftë!Veçse ju ka shkuar huq!Nuk mund t’ju urojmë:Të trashëgoheni! S’ka kohë edhe për një bebush!...

Gruaja – Mos qaj hallin tonë!Të paktën askush nuk do të na e truaj emrin si ty!

Burri me karrocë – *(ju bashkon duart)*Sot,me datën 18 shkurt të vitit aq e kaq,në emër të ligjit të frymës së fundit të shpirtit,unë, mbrojtësi fanatik i ligjit të shtetit,të përdhosur, të lakuar e të përthyer sipas rastit e dëshirës,për minutat e mbetura në këtë botë dhe për amshimin në atë të përjetëshmen,ju deklaroj burrë e grua!*(burrit me borsalinë)* Mund ta puthni nusen tuaj!*(ata puthen)*

(Në korridor nga ashensori del një burrë që afrohet tek dera dhe i bie ziles.Burri me mjekërr sulet i pari.Edhe Gruaja e burri me borsalinë shkojnë drejt derës.Burri me kostum bën dy tre hapa.Burri me karrocë lëviz paksa karrocën)

Burri me mjekërr – *(thërret)*Shpëtuam!Shpëtuam!Këtu,këtu jemi!

Zonja – Na falni,po nuk mund ta hapim derën!Kush është?

I porsaardhuri – Kam një informacion, se në këtë apartament ndodhen disa të vdekur...

Burri me mjekërr – *(lehtë)*T’u thaftë goja!*(fort)*Jemi shtatë njerëz, po që mund të kthehem në kufoma,neqoftese ti nuk bën diçka...

I porsaardhuri – Unë për të bërë diçka kam ardhur!...Sa thatë, shtatë?Unë kam informacion për gjashtë!

Burri me mjekërr – Shtatë,shtatë,po shpejto, lajmëro policinë dhe ambulancën... Ndoshta ka prap shpresë!..

I porsaardhuri – Shumë mirë!A mund të më thoni sa femra e sa meshkuj?*(nxjerr një bllok)*

Burri me mjekërr – Vrapo,more njeri,vrapo,janë shtatë jetë njerëzish në rrezik...Të lutem,merr në telefon sa më parë,se afati po mbaron...

I porsaardhuri – Rri i qetë,zotëri,për ju do të vijmë nesër herët në mëngjes...Agjencia ime e funeraleve quhet “Dyert e parajsës” dhe është me nam në gjithë qytetin!Do të kujdesemi që gjithçka të shkojë vaj!Ju prehuni të qetë!

Burri me borsalinë – Si të prehemi,more,ne jemi ende gjallë!Ti po bën një krim!Po u mohon ndihmën dhe po braktis shtatë njerëz, që mund të shpëtojnë!...

Burri me mjekërr – Gjithë jetën ka për të të vrarë ndërgjegja!Dhe gjumë të rehatshëm kurrë s’ke për të bërë,se fantazmat tona do të rrinë te koka e shtratit e të të ndukin e të të shkulin flokët!...

I porsaardhuri – Ohu,sa kam përcjellë si ju!...Ishin gjashtë, u bënë shtatë!Ku ta gjej këtë rast!Më ra spata në mjaltë!Udhë të mbarë,miqtë e mi!Zoti ua lehtësoftë mundimet!*(Ai largohet.Burri me mjekërr i bie fort derës duke thirrur:”Mos ik!Mos ik!” Muzikë. Kthehen të dërrmuar në vendet e tyre.)*

Vajza – *(burrit me mjekërr)*Përse i thatë nëpunësit të funeraleve, se ishit shtatë?

Burri me kostum – *(nxiton)*U hutua...Ne jemi gjashtë...U ngatërrua...

Burri me mjekërr – *(i përhumbur)*lku!lku dhe shansi i fundit!

Burri me borsalinë – Siç ikën një anije, kur ti je gjysëm i vdekur në një ishull të humbur...

Burri me mjekërr – E po,kaq e pat, më duket!

Burri me kostum – Ke frikë?

Burri me mjekërr – Kam...

Burri me kostum – Kjo tregon se je trim!...Frika është shprehje e trimërisë!...

Burri me mjekërr – Çfarë lesh trimi!Mua më dridhen leqet e këmbëve...Si nuk të njoha më parë!

Burri me kostum – Mos e vrit më mendjen!...Përgatitu!...

Burri me mjekërr – *(me gjysëm zëri)*Ndjehem i këputur...Po më errën sytë...
(rrëzohet.Ata sulen ta kapin)

Zonja – Puls i rreh dobët!

Burri me borsalinë – Dale t'i kontrolloj gishtat e këmbës,se mos kanë filluar të ftohen..Aty nis...

Zonja – Ju lutem,kapeni...Ta çojmë në dhomë!..

(Burri me borsalinë dhe burri me kostum e kapin dhe e fusin në njërën nga dhomat në ballë.Kur hapet porta në dy kanata, duket që dera nga brenda ka formën e arkivolit)

Gruaja – lku njeri!...Kështu paska qenë e thënë!...

Vajza – Ju mund të ishit një çift ideal,zonjë!...

Gruaja – Nuk qe e thënë...

Vajza – Si ndihesh,gjysh?

Burri me karrocë – Disi i lehtësuar...Je apo nuk je mbesa ime,pak rëndësi ka...Ti më fale dashurinë, të cilën kishte vite që e prisja...Tani që po vjen fundi, e sidomos,kur gjoja ligjërova martesën e këtyre dy mjeranëve,pësova një krisje këtu brenda...Për një çast m'u bë, sikur po të puthja ballin në ditën e dasmës tënde!...(ajo e përqafo)

(Ata të tre dalin nga dhoma e ulen nëpër vende.Burri me borsalinë i afrohet dritares.)

Zonja – (gruas)Përse ke rënë në mendime?

Gruaja – A thua e kapim mëngjesin?

Zonja – Pse pyet?

Gruaja – Se dua edhe një herë, para se të vdes, të shoh agimin të lind! Gjithmonë e kam pritur me emocion të veçantë përskuqjen e horizontit në agim...

Zonja – Nuk ma merr mendja!...Ka mbetur edhe pak kohë!...

Gruaja – Thonë, se para vdekjes të vjen parasysh e tërë jeta...Po mua vetëm dy gjëra më sillen e pështillen...Miku im i fëmijërisë, mësuesi plak, dhe kjo natë e shkurtër dhe unë e veshur me të bardha...

Vajza – (*burrit me kostum*) A është e mundur, qoftë edhe vetëm një herë t'ju quaj baba, jeni apo s'jeni babai im?

Burri me kostum – Nuk e kam ditur dhe as kam dashur të di, se ç'ndjen njeriu, kur dikush e quan kështu...Të vika mirë...

Vajza – Si ndihesh?

Burri me kostum – Më merret pak fryma...Kam nevojë për ajër...

Vajza – Edhe zëri sikur u është ngjiruar...

Burri me kostum – U bë ç'u bë tani...

Vajza – Jeni penduar...?

Burri me kostum – Kam mësuar diçka...

Vajza – A mund të ma thuash?

Burri me kostum – Edhe më i fuqishmi do të ishte ndryshe, po ta dinte, se si i vjen fundi...

Gruaja – (*i afrohet burrit me borsalinë te dritarja*) Je penduar?

Burri me borsalinë – Për çfarë?

Gruaja – Që erdhe sonte këtu!...

Burri me borsalinë – Njeriu nuk vdes, kur i vdes trupi, po shpirti...Unë isha si i vdekur prej kohësh...Isha një qenje e gjallë me shpirt të vdekur...Këtu, qoftë edhe për pak çaste rilinda... (*ajo e përqafton*)

Gruaja – Shiko sa i bukur duket qyteti, pas asaj fortune...

Burri me borsalinë – Nuk kam të ngopur...Dua të rok me sy çdo gjë të botës që po lë...

Gruaja – (*të gjithëve*) Të them të drejtën, tani kam filluar të ligështohem...Më duket sikur shoh ëndrra me sy hapur...

Burri me borsalinë – Po edhe vetë jeta një ëndërr është..Vetë ëndrra është e shkurtër, zgjat vetëm disa sekonda,apo pak minuta...Edhe jeta po kështu...Fëmija mezi pret të rritet,pastaj nuk duron sa të martohet...Ja,pastaj, sa të më rriten fëmijët,po kur ata janë rritur,pleqërinë e ke mbas dere...A nuk të duket se e tërë kjo zgjat sa një ëndërr?

Zonja – Zbritju këtyre edhe minutat,orët e ditët e çuara dëm me inate,zënka,mëri,fyerje, fjalë,thashetheme,intriga...Sa pak jetë për të qënë që mbetet!...

Vajza – Prandaj duhet jetuar çdo sekondë ashtu siç e meriton të jetohet!Një poet i famshëm ka thënë: “Nuk duhet harruar asnjëherë se kjo ditë nuk do të lindë përsëri...E vetmja pronë e sigurtë është e sotmja...”

Burri me karrocë – A duket Memoriali i Martirëve që aty?

Burri me borsalinë – Po, duket...Ata kanë mbetur të pavdekshëm...Po për ne çdo të thonë?!...(dritat.Muzikë.)

(Ndezen dritat.Në sallon janë Zonja dhe Vajza.)

Zonja – Të lumtë!Ke qënë një aktore e vërtetë!Tani të nxitojmë pak, se edhe mua po më vjen gjumë...

Vajza – Edhe mua!Ç’gallatë do të jetë nesër në mëngjes, kur të zgjohen pas një nate në “botën tjetër!

Zonja – Ma do mendja se nuk do të mërziten,kur ta shohin veten të rikthyer në jetë...

Vajza – Edhe ti,ama,ke mbledhur shume material për librin tënd!...Kisha edhe një pyetje,vërtetë ka ai burri me kostum një vajzë si unë?

Zonja – Ku i dihet!Edhe mund të ketë!...

Fund

Shkodër,më 19.03.2012

